

SHQIPËRI
WIND
CALL YOUR COUNTRY
TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
INFORMACIONE WIND.IT

Bota shqiptare

www.shqiptariitalise.com

SHQIPËRI
WIND
CALL YOUR COUNTRY
TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
INFORMACIONE WIND.IT

il mondo albanese
IL GIORNALE DEGLI ALBANESE IN ITALIA
Quindicinale - Anno XIII - Nr. 265
1 - 15 settembre 2011 € 1,50

Iscrizione Registro Stampa del Tribunale di Roma nr. 213/99 del 12.05.99 (cambiamenti in corso). Iscrizione ROC nr 13252. Direttore Responsabile Roland Sejko Stampa: CSQ - Centro Stampa Quotidiani S.p.A Erbusco, BS. Distribuzione nazionale edicole: Messaggerie Internazionali SpA. Tariffa R.O.C.: Poste Italiane s.p.a. - Sped. A.P. - D.L. 353/2003 (L. 46/2004) art.1, c.1,1 - CNS/AC - Roma

Redazione: Via Eleonora Duse 53, 00197 Roma. Tel 06-94354511 Fax 06-97998632. Email: botashqiptare@stranieriitalia.it

ISSN 1720-3678
0 0 2 6 5
9 771720367001

Sanatore e re për të huajt, tre miliardë euro në vit për Italinë

Kaq vlej në 500 mijë tak-sapagues më shumë. Për të luftuar krizën, do të mjaftonte një normë e re prej pak rreshtash në kuadrin e manovrës ekonomike.

Propozimi i stranieriitalia.it

Duket se ministrit Tremonti deri tani i ka shpëtuar një thesar i konsiderueshëm: janë miliardë në vit që mund të ndihmojnë Italinë të dalë nga kriza. Do të mjaftonin dy rreshta në brendësi të manovrës ekonomike që të parashikonin legalizimin e punonjësve imigrantë pa leje qëndrimi.

Ideja është e Stranieriitalia.it, portalit të të huajve në Itali. Dhe duket frytdhënëse qoftë për ekonominë italiane, qoftë për qindra mijëra të huajt "e padukshëm" për sistemin Itali.

"Një zgjedhje e këtij tipi do të ishte edhe një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e integritetit. Do t'u jepte mundësinë qindra mijëra imigrantëve që jetojnë e punojnë në Itali të kontribuojnë në mirëqenien e atdheut të tyre të ri" komenton Gianluca Luciano, administratori i shtëpisë botuese Stranieri in Italia.

"Shpresojmë - përfundon - që klasa politike të ketë fantazinë dhe inteligjencën e duhur për të mos lënë t'i shpëtojë ky rast".

Sa janë në të vërtetë të huajt klandestinë? Është vështirë të thuhet me saktësi, por

vijon në faqen 3

MANOVRA EKONOMIKE Lega fut duart në xhepat e imigrantëve



Italia është në krizë e ka nevojë për para. Edhe këtë radhë Lega provon të nxjerrë diçka më shumë prej imigrantëve. Taksë mbi dërgesat dhe 3 mijë euro për jokomunitarët që hapin dalin të punojnë më vete me partita IVA. Janë dy amendamentet anti-imigrantë të depozituara në Senat. Njëri duket i kotë, tjetri është hedhur poshtë disa herë. Por nuk mungojnë propozime më folklorike si "T'i përzëmë e t'u konfiskojmë gjithë ç'kanë" apo "T'u heqim pensionin social". Ndërkohë, e përditshmja Padania hedh poshtë si "të pacipë", propozimin për një sanatore për të huajt.

faqja 2-3

MEDALJE PËR FERRAGOSTO

Nga Ardian VEHBUI

Sikurse u njoftua në shtyp, Presidenti i Republikës Shqiptare Bamir Topi vizitoi ditët e para të gushtit qytetin e Barit, në Itali, ku edhe dekoroi, ndër të tjera, Komunën e Barit me "Medaljen e Mirënjohjes".

Ka pasur dy valë të mëdha refugjatësh shqiptarë drejt Italisë: në mars të vitit 1991 dhe në gusht të vitit 1991. Ekzodi i dytë, në mes të stinës turistike verore, u shoqërua me masa të rrepta kundër të ardhurve, të cilët i mbyllën me forcë në stadiumin e vjetër të Barit, ku i lanë të piqen në diell me ditë të tëra; pastaj i nxorën që andej dhe, me dredhi, i riadhesuan me urë ajrore.

Për fat të keq, në fjalën e vet, Presidenti Topi i referohet shprehimisht mbërritjes në Bari të anijes "Vlora" të ngarkuar me refugjatë në gusht të 20 vjetëve më parë, çka ia largon lexuesit çdo dyshim: ai u shpreh mirënjohjen autoriteteve italiane për një fiasco që, këto vetë, do të kishin dashur ta harronin.

faqja 11

Rregulla të reja qëndrimi dhe dëbimi

Më 2 gusht 2011, Parlamenti italian ka miratuar përfundimisht, përmes konvertimit në ligj, dekretligjin nr. 89/2011. Dekreti ka sjellë një sërë risish të rëndësishme që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e shtetasve të huaj në Itali, qofshin këta komunitarë apo jo. Parlamenti, gjatë konvertimit, ka modifikuar disa dekretin por pa e ndryshuar thelbin e tij.

faqja 6



shqiptariitalise.com
portali i komunitetit shqiptar në Itali

WESTERN UNION | **yes!**

Bota shqiptare

il giornale degli albanesi in italia

testata vincitrice del premio giornalistico M. Souhir per la multiculturalità nei media come MIGLIOR GIORNALE PER GLI STRANIERI IN ITALIA

viti XIII i botimit / anno XIII

E përdyjavshme informative-kulturore e shqiptarëve në Itali.

QUINDICINALE DI INFORMAZIONE E CULTURA DEGLI ALBANESE IN ITALIA.

BOTIM I / EDITORE

Keti Biçoku
Via Domenico Ragona 41,
00143 Roma

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës me dekret

TESTATA ISCRITTA AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA n. 213/99 del 12.05.1999

REDAKSIA / REDAZIONE
Via Virgilio Maroso 50,
00142 ROMA

Tel. 06-94354511
Fax 06-97998632
Cell. 393-9712595

www.shqiptariitalise.com
botashqiptare@stranieriitalia.it

DIRETTORE RESPONSABILE
Roland Sejko

REDAKSIA / REDAZIONE
Keti Biçoku, Irida Cami

BASHKËPUNËTORË/ COLLABORATORI
Rando Devole, Giuseppe Chimisso, Albana Temali, Afërdita Shani, Ivan Muccari (grafico)

LEGISLACION EMIGRACIONI
LEGISLAZIONE D'IMMIGRAZIONE A CURA DI
Stranieri in Italia srl, Roma
www.stranieriitalia.it

REKLAMAT
Tel. 06-94354505
pubblicita@stranieriitalia.it

SHTYPI / STAMPA
Centro Stampe Quotidiani spa
Via dell'Industria 52,
25030 Erbusco (BS)

Shpërndahet në të gjithë Italinë në pikëshitjet me shtyp në gjuhë të huaj

DISTRIBUZIONE NAZIONALE NELLE EDICOLE DI STAMPA ESTERA
Messaggerie internazionali SpA
Via A. Manzoni, 8
20089 Rozzano (MI)
Tel. 02-57512612

DORËSHKRIMET NUK KTHEHEN.
ARTIKUJT E PANËNSHKRUAR JANË TË REDAKSISË

Elvio PASCA

Lega nuk heq dorë e provon sërish të fusë duart në xhepat e imigrantëve me dy amendamente në manovrën ekonomike në diskutim në Senat.

Amendamenti i parë, i përfolur edhe nga e përditshmja legiste Padania, dëshiron të tatojë edhe më shumë paratë që imigrantët dërgojnë në vendlindje. Teksti i paraqitur nga senatorët Vaccari dhe Garavaglia parashikon futjen e "një tatimi mbi transferimet e parave jashtë shtetit përmes instituteve bankare, agjencive "money transfer" dhe agjentëve të tjerë të sektorit financiar". Tatimi duhet të jetë "2% e shumës që transferohet me çdo operacion, për një minimum të tatimit prej 3 eurosh".

Por këtu bëhet një përjashtim i madh: "Përjashtohen transferimet e kryera nga subjektet me matrikullin INPS dhe kodin fiskal". Më një fjalë, tatimi i ri nuk duhet të prekë punonjësit e rregullt, që detyrimisht janë që të gjithë të regjistruar në institutin e sigurimeve shoqërore dhe arrijnë të marrin kodin fiskal edhe më përpara se

MANOVRA EKONOMIKE Lega fut duart në xhepat e imigrantëve

Italia është në krizë e ka nevojë për para. Edhe këtë radhë Lega provon të nxjerrë diçka më shumë prej imigrantëve. Taksë mbi dërgesat dhe 3 mijë euro për jokomunitarët që hapin dalin të punojnë më vete me partita IVA. Janë dy amendamentet anti-imigrantë të depozituara në Senat. Njëri duket i kotë, tjetri është hedhur poshtë disa herë. Ndërkohë, e përditshmja Padania hedh poshtë si "të pacipë", propozimin për një sanatore për të huajt

Imigrantët do të shpëtojnë pensionet në Itali

Sipas të përditshmes Il Sole 24 Ore rritja e popullsisë së huaj do të garantojë jo vetëm sistemin e pensioneve, por edhe rritjen e popullsisë

Pensionet falë emigrantëve." Ky është me shumë pak fjalë rezultati i hulumtimit të fundit të kryer nga e përditshmja ekonomike "Il Sole 24 Ore" e cila i ka kushtuar faqen e rubrikës "udhëzuesi i krizës" rëndësisë që luan pesha demografike e emigrantëve në sistemin italian të punës dhe të pensioneve.

Duke u nisur nga numri i emigrantëve të pranishëm në Itali, gazeta fillimisht shqyrton ndikimin e rëndësishëm të të huajve në treguesin e rritjes së vendit, duke vënë në dukje se në vitin 2011 rritja e popullsisë ka arritur pothuajse në 380 mijë vetë. Ky rezultat është meritë kryesisht e të huajve, mes të cilëve rritja ka qenë rreth 120 mijë vetë.

Numra të rëndësishëm që dëshmojnë rritjen e qëndrueshme të emigrantëve në Itali. Gjatë vitit 2010 ata përbënin 7,5% të popullsisë së përgjithshme dhe me një rritje prej 7%, i cili ndihet kryesisht në qendër e veri të ven-

dit. Kjo rritje mund të konsiderohet normale nëse krahasohet me atë të vendeve të tjera evropiane, ku numri i të huajve përbën rreth 10-12% të popullsisë së përgjithshme. Në këtë klasifikim të veçantë,

Italia zë vendin e gjashtë, pas Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë.

Sipas analizës së gazetës Il Sole 24 Ore, të huajt jo vetëm ndikojnë në rritjen e popullsisë, por janë gjithashtu

shumë aktive në punësim; të huajt në grup moshat e punës janë 63,1% kundrejt 56,3% e italianëve, edhe pse treguesi i papunësisë është i lartë mes të huajve, të prekur nga kriza më shumë se italianët.

Domethënëse edhe të dhënat që kanë të bëjnë me ngritjen e bizneseve të reja, ku është shënuar një rritje prej 29 mijë njësish mes të huajve, sinjal i iniciativës dhe dëshirës për të investuar në Itali.

Sipas këtyre të dhënave, gazeta skicon një bilanc pozitiv për të ardhmen, në një kontekst në të cilin popullsia italiane është në rënie dhe një vjetërsim gjithnjë e më të madh të popullsisë. Do të jetë pikërisht popullsia e re e të huajve që e integruar në nivel punësimi, do të përbëjë një element themelor në politikën sociale italiane dhe mbi të gjitha do ta bëjë të përballueshëm sistemin e pensioneve.

Pdl Liguria: "T'u heqim pensionet imigrantëve"

Gianni Plinio, përgjegjës për sigurinë i Popullit të Lirive të Ligurias, i ka shkruar javën e shkuar ministrit të Ekonomisë Giulio Tremonti, për ta këshilluar që të fusë në manovrën ekonomike që po studiohet në Parlament një normë që t'u heqë të drejtën e pensionit social imigrantëve mbi 65 vjeç. Pasi, sipas tij, "rëndon në bilancin e shtetit" dhe "prek interesat e qytetarëve italianë që e kanë këtë të drejtë".

"Është qesëndi dhe padrejtësi ndaj pensionistëve të shumtë italianë" nënvizon Plinio, që akuzon ligjin e vitit 2000 të aprovuar nga qeveria e qendrës së majtë e Giuliano Amatos, në bazë të të cilit jokomunitarët mbi 65 vjeç pa të ardhura marrin nga Instituti italian i sigurimeve shoqërore rreth 500 euro në muaj.

"Ata marrin këtë shumë – pohon Plinio – edhe nëse nuk kanë derdhur asnjë qindarkë kontribute në të shkuarën" dhe për më tepër "kanë mundësi të tërheqin çekun social, edhe nëse kthehen në atdhe".

Sipas përgjegjës për sigurinë të Pdl Liguria, shuma e përgjithshme që INPS nxjerr çdo vit për pensionet e imigrantëve është pak a shumë 50 milionë euro. "Një shpenzim shumë i madh për publikë – përfundon ai – që duhet eliminuar".

lejen e qëndrimit.

Praktikisht duket sikur amendamenti dëshiron të tatojë kursimet që dërgojnë në atdhe klandestinët, ndoshta edhe duke marrë parasysh që paratë e imigrantëve të rregullt janë të taksuar njëherë, njësoj si të

Sanatore e re? Padania: "Propozim i pacipë"

Përgjigjja e të përditshmes së Legës sugjerimit të Stranieriinitalia.it. "Shoqëria nuk është gati, paratë nuk janë gjithçka". Është më mirë për Italinë të ketë 500 mijë klandestinë?

"Të legalizojmë 500 mijë klandestinë për të bërë ca para". E thatë por efikase, mënyra në të cilën dje e përditshmjia Padania sintetizoi idenë e hedhur nga Stranieriinitalia.it. Por duke e damkosur, që në titull të rubrikës si "propozim të pacipë".

Të përditshmes së Legës nuk i pëlqen ideja e "shkëmbimit të një grushti para [3 miliardë euro në vit] me një vendim për të cilin shoqëria italiane mund të mos jetë sot gati: t'u dhurojë 500 mijë leje qëndrimi klandestinëve që aktualisht nuk e kanë". "Lega e veriut - shton - e ka thënë gjithnjë: ekonomia nuk është gjithçka. Dhe rrënjët e identitetit të popullit tonë vlejnë më shumë se një peshtaf me flori".

Duket se kjo "shoqëri" e çuditshme e skicuar nga Padania do të mbetet e shokuar nëse gjysmë milioni punonjësish që e ëndërrojnë të paguajnë taksat e kontributeve do të dilnin në dritë. Ky "popull" i çuditshëm do të rrezikonte zhdukjen vetëm po të dëgjonte fjalën sanatore.

Epo mirë atëherë, le të mbeten legistë të lumtur, e të pranojnë që t'u pastrojnë shtëpitë, t'u mbajnë prindërit e fëmijët, apo t'u shërbejnë kafënë një turmë e madhe kriminelësh (klandestiniteti është vepër penale në Itali), që nuk derdhen as edhe një grosh në arkat e shtetit dhe që asnjë nuk do të jetë i aftë të përzërë. Nëse u pëlqen kështu...
E. P.



ardhurat nga puna të italianëve. Por Vaccari e Garavaglia arrijnë me vonësë, dhe vështirë se me propozimin e tyre do të mund të mbushin arkat e shtetit. Dy senatorëve duket se u ka shpëtuar që prej dy vjetësh klandestinët nuk mund të dërgojnë para (përmes

kanaleve zyrtare, të paktën) në shtëpi e pikërisht për shkak të një tjetër legisti. Paketa e sigurisë e vitit 2009, krenaria e ministrit Maroni, detyron operatorët e "money transfer" t'u kërkojnë klientëve të huaj lejen e qëndrimit.

Mes amendamenteve të Legës është edhe një tjetër me të cilin duan të detyrojnë imigrantët që duan të punojnë më vete të japin më shumë garanci se italianët.

Në veçanti, "në çastin e hapjes së partitë IVA nga një shoqëri apo qytetar jokomunitar, për të garantuar pagesat e ardhshme të taksave dhe të kontributeve gjatë ushtrimit të aktivitetit, të depozitohet një fidejksion bankar apo sigurimesh në favor të Agjencisë së të Ardhurave, një shumë prej të paktën 3 mijë eurosh". Garancia, "do të kthehet kur aktiviteti të mbyllet dhe pasi të jenë kryer të gjitha derdhjet fiskale dhe të kontributeve nga shoqëria apo personi fizik i huaj".

Kjo historia e fidejksionit për aktivitetet private nuk është aspak e re. Lega ka paraqitur edhe më parë, madje disa herë, propozime të tilla në parlament. Deri tani nuk i ka ecur, të shohim si do t'i shkojë këtë radhë.

Sanatore e re për të huajt, tre miliardë euro në vit për Italinë

Propozimi i stranieriinitalia.it

Vijon nga faqja e parë

studimi i fundit i ISMU-t, (duke i konsideruar me të metë, për të qenë sa më i kujdesshëm) thotë se janë të paktën 500 mijë, një ushtri e tërë personash të padukshëm. Të papërfillur nga sanatoria e shtatorit të 2009-tës dhe të mbetur jashtë nga dekreti i fundit i flukseve, ëndërrojnë që të gjithë një leje qëndrimi.

Nga ana tjetër Italia, duke u dhënë atyre shansin e dokumentit të qëndrimit, ka veç përfitim: do të mblidhte për arkat e shtetit edhe më shumë nga ç'parashikonë shumë nga shkurtimeve e kontestuar që po shqyrtohen në Parlament.

Llogaria është e thjeshtë. Të supozojmë që janë 500 mijë vetë. Për legalizimin e çdo personi mund të kërkohej - ashtu si dy vjet më parë - një kontribut forfetar prej 500 eurosh, që do t'u sillte arkave të shtetit menjëherë 250 milionë euro.

Por fitimi i vërtetë ekonomik i vendit do të ishte - padyshim më i bëshëm dhe i qëndrueshëm në kohë - ai i vjeljes së taksave nga 500 mijë taksapagues të rinj. Gjithnjë sipas ISMU-t, çdo i huaj me qëndrim të rregullt në Itali derdh mesatarisht - me taksat dhe kontribute - rreth 6 mijë euro në vit. Kështu që, një sanatore e re për të huajt do të sillte në arkat e shtetit tre miliardë euro çdo vit.

Saya: "Të dëbojmë të huajt e të konfiskojmë pronat e tyre"

Në programin e partisë nacionaliste italiane ndalimi i imigracionit dhe përzënia e të huajve që janë në Itali. PD: "Qeveria të ndërhyjë". Genova e alarmuar për rekrutimin e "Legjionet e mbrojtjes së atdheut", që sipas Gaetano Sayas do të mbahet në qytet më 24-25 shtator

Duam të pastrojmë Italinë", proklamoi në faqen e tij internet Gaetano Antonio Maria Saya, lideri i Partisë Nacionaliste Italiane, që ditët e shkuara ka nisur një fushatë për krijimin e "Legjioneve për sigurinë dhe mbrojtjen e atdheut", në pritje të mitingut që po organizon në Genova më 24 dhe 25 shtator.

Saya, që vitet e fundit ka zënë faqet e shtypit për ngritjen e një lloj policie paralele, fut edhe luftën kundër imigracionit mes pikave të programit të tij. "Të gjithë italianët e rinj, jo qytetarë, të klasifikuar kështu nga e drejta janë kushtetuese duhet të largohen nga territori kombëtar" thotë mes të tjerash. Në shënjestrën e tij janë veçanërisht homoseksualët, komunistët, arxhinjtë, shqiptarët, marokenët dhe myslimanët.

Me një fytyrë që të kujton Augusto Pinochet, Charlie Chaplin apo rreshterin Garcia të Zorros, Saya shpjegon edhe që

imigrantët duhet të largohen duke lënë gjithçka kanë këtu. "Pronat e tyre - siguron ai - do të sekuestrohen dhe do të merren nga shteti italian, pra do t'u besohen qytetarëve italianë".

Këto koncepte janë theksuar edhe në programin e partisë



"Të gjithë italianët e rinj, jo qytetarë, duhet të largohen nga territori kombëtar" thotë mes të tjerash. Në shënjestrën e tij janë veçanërisht homoseksualët, komunistët, arxhinjtë, shqiptarët, marokenët dhe myslimanët

Nacionaliste, në të cilin për më tepër premon "të pengojë çdo formë imigracioni të jo italianëve" dhe të "detyrojë të gjithë jo italianët të ardhur në Itali pas 31 dhjetorit 1977 të largohen nga territori italian".

Ndërkohë Emanuele Fiano, kryetar i forumit për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Partisë Demokratike, kërkon që qeveria të ndërhyjë sa më shpejt për të penguar përhapjen e ideve që nxisin urrejtjen raciale: "Idetë e tij janë emblematike të një kulture fashiste, të dhunshme dhe raciste". Ministria për Shanset e Barabarta ka hapur një hetim mbi deklaratat e Sayas.

Ndërkaq Genova është e shqetësuar për atë që mund të ndodhë më 24 dhe 25 shtator kur, sipas lajmërimeve të botuara në facebook, Saya do të organizojë në qytet rekrutimin për "Legjionet e mbrojtjes së atdheut", milicia që do të ketë në shënjestër mes të tjerësh edhe shqiptarët, marokenët, myslimanët, arxhinjtë por

edhe komunistët e homoseksualët. Një miting i tillë konsiderohet një provokim i pastër nga qendrat sociale të qytetit ligur dhe nga shoqatat e shumta luftojnë racizmin e diskriminimin.



ISI RICERCA HOSTESS E PROMOTER INTUTTA ITALIA.

I candidati si occuperanno della promozione e vendita dei servizi ISI direttamente nel punto vendita. Si richiede precedente esperienza in attività di vendita, e disponibilità immediata a lavorare sia part time che full time, che nel fine settimana. Completano il profilo dinamicità, flessibilità e forte predisposizione alla vendita nonché massima serietà e disponibilità.

Se interessati mandare curriculum con foto a:
e-mail: customerservice@isi.eu.com
oppure telefonare orario ufficio ai numeri
06 87410555 - 06 87410412

FLUKSET

Dhjetë mijë hyrje për të marrë një profesion

Përcaktohet numri maksimal i kuotave. Kërkesat në konsullata, por vetëm për kurse dhe stazhe të miratuara nga krahinat

Dhjetë mijë të huaj do të mund të vijnë në Itali këtë vit për të marrë një profesion. Praktikisht për të ndjekur kurse formimi profesional apo stazhe formimi dhe orientimi. Kufiri maksimal i vizave të hyrjeve është përcaktuar nga një dekret fluksesh në miniaturë i miratuar më 11 korrik nga ministria e Punës dhe e Politikave Sociale dhe i botuar më 29 gusht në Gazetën Zyrtare.

Pesë mijë hyrje do të jenë për ata që marrin pjesë në kurse formimi, të organizuara nga ente të akredituara, që mund të zgjasin 2 vjet e që duhet të parashikojnë lëshimin e një kualifikimi apo të një dëshmie mbi kompetencat e fituara. Pesë mijë hyrjet e tjera do të jenë për ata që duan të bëjnë stazhe,



që duhet të zhvillohen sipas një projekti të miratuar nga autoritetet kompetente, të ndryshme nga Krahina në Krahinë.

Të huajt që duan të përfitojnë nga ky dekret fluksesh duhet të paraqiten në konsullatën italiane në vendlindje ku,

bashkë me kërkesën e vizës, ë dorëzojnë edhe dokumentacionin lidhur me kursin apo stazhin që do të ndjekin në Itali.

Kush vjen në Itali përmes këtij kanali ka të drejtën e një lejeje qëndrimi për studime që mund të konvertohet në leje për punë vetëm nga ata, që në fund të kursit apo të stazhit do të gjejnë një punëdhënës të gatshëm për ta punësuar, por sidoqoftë në brendësi të kuotave për konvertimet që qeveria përcakton me dekretet e zakonshme të fluksëve.

Në Shqiptariitalise.com gjeni udhëzuesin e praktikës që ndiqet për të ardhur në Itali me këto fluksë.

Elvio Pasca

Shpërndahen 1.300 kuota të reja për konvertimet e lejeve të qëndrimit

Do të shërbejnë për të pranuar kërkesat që kanë mbetur pa përgjigje. Ministria e Punës: "Përparësi punonjësve stinorë me lejeqëndrim që po u skadon".

Në fund të korrikut u janë shpërndarë provincave italiane edhe rreth 1.300 kuota të reja për konvertimet e lejeve të qëndrimit.

Do të shërbejnë për të plotësuar kërkesat e fluksëve 2011, që mund të jenë paraqitur deri në qershor 2011. Edhe këto janë kuota të përfshira në dekretin e fluksëve por që deri më sot ministria e Punës nuk kishte shpërndarë pasi donte që më parë të kishte një kuadër të saktë të kërkesave në provinca.

Shpërndarja e këtyre kuotave do të mundësojë 597 konvertime nga leje qëndrimi për studime e stazh në leje për punë të varur, 571 konvertime nga leje për punë stinore në leje për punë të varur, 99 konvertime nga leje për qëndrues afatgjatë të lëshuara nga vende të tjera të BE-së në leje për punë të pavarur.

Nga një vështrim i shpejtë i tabelave që mund të shkarkoni në lidhjen poshtë artikullit, praktikisht ministria i ka dhënë çdo province aq kuota sa ç'ka pasur edhe kërkesa, që do të thotë se kërkesat e konvertimeve po pranohen të gjitha.

Do t'i jepet përparësi 571 personave që konvertojnë një leje për punë stinore, veçanërisht nëse ajo po i afrohet skadimit. "Janë punonjës të pranishëm në Itali, që mund të rrezikojnë të kthehen në klandestinë, apo të humbin vendin e punës" shpjegon Natale Forlani, drejtori i imigracionit në Ministrinë e Punës.

Acquaformosa, komuna e shpëtuar nga imigrantët

Komuna me më pak se një mijë banorë rrezikonte të eliminohej dhe të bashkohej me një tjetër aty pranë. Mbërritja e refugjatëve shpëton fshatin dhe shkollën

Ka nga ata që i konsiderojnë përgjegjës për papunësinë apo kriminalitetin, të tjerë që duan t'u vënë taksë mbi kursimet e tyre, të tjerë akoma që duan të mos i lënë të futen. Por ka edhe të tjerë që tek të huajt gjejnë shpëtim. Si banorët e Acquaformosas, një fshat i vogël në Kalabri. Që rrezikonte të zhdukej si njësi administrative për rënien e vazhdueshme demografike, për shkak të cilës sot ka më pak se një mijë banorë.



Sipas normës së re të manovrës financiare, fshatrat me më pak se një mijë banorë duhet të bashkohen me një tjetër ngjitur. Dhe ky do të ishte fati i Acquaformosas sikur kryetari i komunës tre vjet më parë të mos kishte përkrahur projektin Sprar, falë të cilit i ka ofruar rezidencën disa

familjeve refugjatësh.

Shërbimi për Mbrojtjen e Kërkuësve të Strehimit dhe i Refugjatëve i ministrisë së Brendshme, parashikon në fakt që komunat që shprehin gatishmërinë të marrin familje imigrantësh të cilëve u njihet statusi i refugjatit.

Në këtë mënyrë kryetari i komunës ka marrë katër familje, rreth 30 per-

sona të cilët, siç thekson Corriere della Sera, kanë kontribuar në riaktivizimin e sistemit shoqëror dhe ekonomik të fshatit kalabrez.

Sipas fjalëve të kryetarit, ardhja e të huajve ka sjellë jo vetëm punë për operatorët socialë që merren me mikpritjen por edhe nxënës të rinj, plot 16, dhe me regjistrimin e tyre në shkollë është fashitur edhe rreziku i mbylljes së strukturës didaktike pikërisht për mungesë nxënësish.

Në fshatin e vogël ku sot ka 1.191 banorë (ISTAT, mars 2011), të moshuarit mbi 60 vjeç përbëjnë rreth 40% të popullsisë, numri i vdekjeve është më i lartë se ai i lindjeve, shpresohet që falë familjeve të reja të imigrantëve kjo prirje të mund të ndryshojë shpejt.

Ma.Io

ZYRË SHËRBIMESH, KONSULENCE DHE PËRKTHIMESH

Përkthime të Autorizuara me Apostille nga Italia ose Shqipëria të Certifikatave të Lindjes për regjistrimin e fëmijëve në Zyrat e Gjendjes Civile në Shqipëri, të Certifikatave Familjare, Martesore, Penale për shtetësinë italiane, Përkthime Prokurash Speciale, Diplomash, Konvertime Patentash, Nulla osta për martesë, Informacione nga interneti mbi pasaportat biometrike, Viza pranë Ambasadave të ndryshme, etj. Dokumentet nisen me postë dhe brenda pak ditësh Ju arrijnë në adresën që dëshironi. Cell. 327.8848348

TIM CARD ALBANIA LIMITED.

Me **6** cent/min flet me të gjithë numrat në Itali dhe numrat fiks në Shqipëri.



Dhe flet me celularët në Shqipëri vetëm me 9 cent/min. Hyr në TIM duke mbajtur numrin tend dhe dyfisho rimbushjet për një vit.

IMPULS NË PËRGJIGJE 16 CENT DHE TARIFIM ME IMPULSE PREJ 30 SEKONDASH.

TELEFONO NË 119, QË SOT EDHE NË GJUHËN TËNDE. OSE HYR NË DYQANET TIM.

Tarifa 6 cent/min është e vlefshme deri në 1000 min çdo 30 ditë për thirrjet drejt Shqipërisë, për thirrjet në drejtim të operatorëve të tjerë celularë vlen për një maksimum prej 200 minutash në javë. Për info mbi kostot pasi të tejkalohe ky limit hyr në www.tim.it. Oferta promociionale "dyfishimi i rimbushjeve" është e vlefshme për ata që kalojnë nga operatorë të tjerë në TIM deri në 04/09/2011. Parashikon një bonus maksimal prej 50€ çdo 30 ditë.



Pasaporta të reja në Romë e Milano

Në Konsullatën e përgjithshme të Milanos, mund të tërhiqen pasaportat për të cilat është aplikuar deri më 12 gusht, ndërsa sipas faqes internet të Ambasadës sonë, më 8 dhe 17 gusht kanë mbërritur në Romë rreth 300 pasaporta të reja për t'u tërhequr

Konsullata e përgjithshme e Shqipërisë në Milano, në faqen e saj të internetit, lajmëron se të gjithë qytetarët shqiptarë që kanë aplikuar për pasaportat biometrike pranë kësaj konsullate nga 28 prilli deri më 12 gusht, mund të paraqiten pranë saj për t'i tërhequr". Natyrisht, nëse nuk e kanë bërë deri më sot.

Sipas lajmërimit on-line të Konsullatës, tërheqja bëhet nga ora 12:00 deri në orën 14:00, nga e hëna në të premte, duke paraqitur faturën e aplikimit dhe një dokument identifikimi. Nëse pasaporta



mund të tërhiqet edhe nga një familjar (me faturën e aplikimit), kush ka paraqitur kërkesë edhe për letërnjoftimin elektronik, duhet të paraqitet personalisht në konsullatë.

Për informacione të ndryshme mund të kontaktoni përmes numrit të celularit +39.3920686139 apo të konsultoni sitin zyrtar të konsullatës së Milanos.

Ndërsa Zyra konsullore e Ambasadës shqiptare gjatë gushtit ka përditësuar listën e pasaporta të gatshme, me rreth 300 të reja të sjella në Romë më 8 dhe 17 gusht 2011. Kjo do të thotë se aty mund të tërhiqen dokumentet për të cilat është aplikuar, pak a shumë, deri në ditën e para të gushtit.

Në shqiptariitalisë.com gjeni të përditësuar listën e pasaportave të gatshme të arritura në Ambasadë deri më 8 gusht. Kush gjen emrin në listë e nuk e ka tërhequr ende pasaportën biometrike dhe letërnjoftim elektronik, mund të paraqitet pranë Ambasadës së Shqipërisë në Romë për t'i tërhequr ato në oraret 13:00 - 15:00 nga e hëna deri të premten.

Për tërheqjen duhet të paraqiten me një dokument identiteti me foto dhe me faturën e aplikimit.

Tërheqja e letërnjoftimit bëhet vetëm në praninë e personit që ka aplikuar, ndërsa për fëmijët pasaporta mund të tërhiqet edhe nga prindi, pa praninë e fëmijës duke pasur me vete një dokument që vërteton lidhjen familjare me fëmijën.

Para se të shkohet në Ambasadë është mirë të pyetet në numrin e celularit të vënë në dispozicion për informacione (0039)342.364.0798 apo të konsultohen faqet internet ku botohet lista e pasaportave të gatshme.

Më 2 gusht 2011, Parlamenti italian ka miratuar përfundimisht, përmes konvertimit në ligj, dekretin nr. 89/2011, të botuar në Gazetën Zyrtare nr 144, në fuqi që nga 24 qershori. Dekreti ka sjellë një sërë risish të rëndësishme që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e shtetasve të huaj në Itali, qofshin këta komunitarë apo jo. Parlamenti, gjatë konvertimit, ka modifikuar disi dekretin por pa e ndryshuar thelbin e tij. Çfarë ndryshon për joko-munitarët

Dëbimi i të huajve klandestinë

Përpara ardhjes në fuqi të dekretit, kushdo që gjendej në territorin italian (qoftë edhe duke u larguar prej tij, pra në dalje në kufi) pa lejen e qëndrimit apo me leje të skaduar dhe të papërtërirë, ndiqej penalisht për veprën penale të hyrjes dhe të qëndrimit të parregullt të dënueshme, përveçse me masën e dëbimit, edhe me një gjobë nga 5 mijë deri në 10 mijë euro.

Sot, shtetasi i huaj i parregullt që identifikohet gjatë kontrolleve të policisë së kufirit në dalje nga territori italian nuk kryen më veprën penale të klandestinitetit, sepse po largohet me dëshirën e tij nga Italia.

Për më tepër, masat e dëbimit, këteje e tutje, duhet të mbajnë parasysh rast pas rasti, situatën e të huajit, si për shembull kohëzgjatjen e qëndrimit, mospasjen mbi shpatulla dënime penale, praninë e familjarëve, por nga ana tjetër, edhe refuzimi i lëshimit të lejes së qëndrimit do të mund të justifikojë një masë dëbimi.

Rregulla të reja qëndrimi dhe dëbimi për imigrantët

Shoqërimi me forcë në kufi

Sipas normave të reja, dëbimi me shoqërim në kufi duhet të vendoset sa herë që një shtetas i huaj i parregullt kapet në territorin italian, por kur ky nuk është i mundur, sepse ky nuk ka pasaportë e nevojiten verifikime mbi identitetin të huajit, vendoset që ai të mbahet në qendrat e identifikimit dhe të dëbimit, Cie.

Shoqërimi me forcë në kufi mund të bëhet edhe kur:

- ekziston rreziku i largimit (mungesa e një dokumenti të vlefshëm për jashtë shtetit apo i një strehimi të përshtatshëm që të lehtësojë gjetjen e personit; dhënia më parë të dhënave personale të rreme, etj;

- kërkesa për leje qëndrimi është hedhur poshtë sepse nuk ishte dukshëm e pambështetur në motive të vlefshme apo sepse kërkesa ishte bërë mbi motive të rreme apo të paqena;

- i huaji, pa asnjë motiv të justifikuar, nuk ka respektuar afatin e largimit me dëshirë nga territori italian të dhënë nga një urdhër dëbimi të mëparshëm.

Riatdhesimi me dëshirë

Dekreti i ri i Qeverisë bën më të lehtë, në krahasim me të shkuarën, mundësinë për të huajin e parregullt largimin me dëshirë nga territori italian, duke parashikuar riatdhesimin e mbështetur dhe mundësinë që t'i kërkohe Prefektit një zgjatje e afatit për t'u larguar.

Kjo procedurë e re u adoptua për t'u përshtatur direktivës evropiane mbi riatdhesimet që, edhe pse nuk ishte nënshkruar nga Italia, sidoqoftë ndikoi në mekanizmin italian të dëbimeve.

Për të kërkuar shtyrjen e afatit të largimit nga Italia i huaji duhet të tregojë se ka burime ekonomike sa trefishi i çekut social dhe Kuestori, që t'i lejojë shtyrjen, mund t'i imponojë një sërë masash si dorëzimin e pasaportës dhe/ose detyrimin e paraqitjes pranë zyrrave të policisë deri në ditën e caktuar për nisjen e tij.

Nëse shtyrja e afatit jepet por i huaji nuk respekton detyrimet, masa e dëbimit ekzekutohet menjëherë dhe i huaji dënohet me sanksionin nga 3 mijë deri në 18 mijë euro.

Vdes një punëtor. Fqinji-punëdhënësi akuzohet për vrasje nga pakujdesia e vihet në arrest shtëpie

Kishte humbur lejen e qëndrimit, dhe për rrjedhojë e kishte të vështirë të gjente një punë. Por me grua e tre fëmijë të vegjël në Castelfiorentino të Firences, nuk është e lehtë të shkosh përpara, aq më tepër i papunë. Ndaj 44 vjeçari Ndoc Gomila i kërkonte shpesh fqinjit të tij Renato Ndreu, 36 vjeç, që punonte më vete në ndërtim, t'i jepte kur të mundej ndonjë punë. E ndoshta ndonjëherë ia ka gjetur vërtet deri më 28 gusht, kur për të inspektuar çatinë e një kabanoni që do të merrte përsipër të rregullonte Ndreu me "firmën" e tij, ndod-

Fatkeqësi në punë. Bie nga 8 metra lartësi dhe humb jetën Ndoc Gomila. Arrestohet titullari i "ndërmarrjes", Renato Ndreu, të cilit i jepet arrest shtëpie. Ky i fundit kur del përpara gjykatës, me lot në sy i shpjegon gjykatës se ishte vetë Gomila, baba i tre fëmijëve që i kërkonte ta ndihmonte duke e marrë në punë

hi tragjedia. Gomila bashkë me Ndreun kanë hipur mbi çati e pa e kuptuar Gomila ka nisur të ecë mbi dy pllaka pleksiglas, që janë thyer nën peshën e tij dhe punëtori ka rënë nga 8 metra lartësi duke vdekur në vend. Ndihmën e shpejtë mundohet t'ia japë edhe vetë Ndreu, por për Ndoc Gomilën nuk mund të bëhet asgjë.

Ndreun e arrestuan menjëherë, por gjykatësi për hetimet paraprake që pas dy ditësh i njohu konvalidimin e arrestit, ia zbuti disi duke ia kthyer nga arrest në burg në arrest shtëpie. Sepse me sa duket u ka besuar fjalëve të Ndreut që



Ndalimi i ri-hyrjes

Më parë kush ishte dëbuar nuk mund të hynte në Itali para përfundimit të 10 vjetëve, me përjashtim të mundësisë së kërimit të një autorizimi special Ministrisë së Brendshme përmes Konsullatës italiane në vendlindje.

Me rregullat e reja ndalimi i ri-hyrjes zgjat nga 3 deri në 5 vjet dhe mund të jetë më i lartë vetëm në rastet e dëbimit për motive rrezikshmërie.

I huaji marrës i masës së dëbimit që është larguar duke respektuar afatin e parashikuar në dekretin e dëbimit, tani ka të drejtë të kërkojë heqjen e ndalimit të ri-hyrjes, duke treguar se është larguar vërtet nga territori italian.

”

Me rregullat e reja ndalimi i ri-hyrjes zgjat nga 3 deri në 5 vjet dhe mund të jetë më i lartë vetëm në rastet e dëbimit për motive rrezikshmërie.

Mbajtja në Cie

Mbajtja në Qendrat e identifikimit dhe të dëbimit bëhet, në përgjithësi, pas dhënies së masës së dëbimit. Kohëzgjatja e mbajtjes mund të shkojë nga 30 ditë deri në 18 muaj, në rast vështirësish për riatdhesim (zgjatja e afatit vendoset nga gjykatësi i paqes për periudha dymujore).

Me mbarimin e këtij afati, nëse nuk ka qenë akoma e mundur të kryhet riatdhesimi i të huajit, Kuestori e urdhëron të largohet nga territori brenda 7 ditëve, duke i dhënë edhe biletën e avionit për t'u kthyer në vendlindje.

Të huajit që pa një motiv të justifikuar nuk largohet, mund t'i jepet një gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë euro, si edhe një urdhër i ri dëbimi që shoqërohet me mbajtjen përsëri në Cie.

Programe të riatdhesimit të asistuar

Mes rregullave të reja është futur një normë e re që parashikon aktivizimin e programeve të riatdhesimit të asistuar. Pranimi i të huajit në këto programe riatd-

hesimi në dëshirë dhe të asistuar ka për pasojë ndërprerjen e masave të dëbimit (me përjashtim të rasteve kur këto masa jepen për motive rrezikshmërie sociale të të huajit) dhe të masave të kufizimit të lirisë. Pranimi në programet e riatdhesimit të të mbështetur nuk parashikohet për të huajt që kanë marrë njëherë pjesë në to, që kanë marrë masën e dëbimit për arsye të rrezikshmërisë apo në rast se i huaji ka shkelur normat e ri-hyrjes dhe masat e marra nga Kuestori. Nuk mund të ndjekin këto programe riatdhesimi as të huajt që kanë marrë dëbimin si pasojë të një sentence penale.

Së fundi, dekreti i kthyer në ligj parashikon që kthimi mbrapsht apo ekzekutimi i dëbimit i personave me aftësi të kufizuara, i të moshuarve, i të miturve, i pjesëtarëve të familjeve me një prind e bij të mitur, apo i viktimave të dhunës psikologjike, fizike o seksuale, të bëhet me mënyra të pajtueshme me situatat e veçanta personale të verifikuara më parë.

Të miturit e pashoqëruar

Ligji i konvertimit të dekretit parashikon, me një shtesë në nenin 32 të Tekstit Unik mbi imigracionin që leja e qëndrimit mund të lëshohet për arsye studimi, për futjen në tregun e punës ose për punë të varur apo autonome, me arritjen e moshës madhore, të miturve jokomunitarë të pashoqëruar të besuar apo të vënë nën tutelë, pas mendimit pozitiv të Komisionit për të miturit e huaj, apo të miturve të huaj të pashoqëruar që janë pranuar për një periudhë jo më të vogël se dy vjet në një projekt të integritit shoqëror dhe qytetar të administruar nga një ent publik apo privat që ka përfarësim kombëtar dhe që sidoqoftë është i regjistruar në regjistrin e ngritur pranë Presidencës së Këshillit të Ministrave.

KRAHINA VENETO

Ndihmë familjeve me shumë fëmijë. Jo emigrantëve

Bonusi u rezervohet vetëm italianëve rezidentë prej 5 vjetësh në krahinë.

ASGI: "Zgjedhje diskriminuese dhe në kundërshtim me të drejtën evropiane"

Krahina e Venetos parashikon të realizojë, me anë të Komunave, një program ndërhyrjesh ekonomike të jashtëzakonshme në favor të familjeve me shumë fëmijë, por vetëm nëse janë italiane me 5 vjet rezidencë. Ngritja e Fondit për familjet me shumë fëmijë, prej një milion eurosh, është miratuar nga Këshilli i Krahinës më 3 gusht. 880 mijë euro do të jenë për familjet me të paktën katër fëmijë, ndërsa 120 mijë për familjet me lindje trinjakësh. Projekti tashmë i filluar, parashikon që kërkesat për të përfutur nga fondi të mund të paraqiten deri më 31 tetor.

Përveç shtetësisë italiane dhe rezidencës 5 vjeçare në Veneto, kërkuesit e bonusit duhet të kenë të ardhura vjetore deri në 30 mijë euro, që do të tregojnë përmes treguesit ekonomik ISEE të vitit 2010.

Iniciativa diskriminon të gjithë shtetasit e huaj rezidentë në krahinë, të përjashtuar nga e drejta e bonusit. Për këtë arsye ASGI, shoqata për studimet juridike mbi imigracionin, ka nënshkruar një dokument që ia ka nisur Presidentit të krahinës, ANCI

Veneto, UNAR-it dhe Komisionit evropian. Sipas ASGI-t, iniciativa e Krahinës është në kontrast me "Kushtetutën dhe të drejtën e Bashkimit Europian, pasi përbën diskriminim në dëm të qytetarëve të tjerë të BE-së dhe të qytetarëve të vendeve jo anëtare të Bashkimit Europian". Për më tepër, ASGI nënvizon se janë shkelur "parimet kushtetuese të barazisë dhe të arsyeshmërisë, për të cilat është shprehur edhe Gjykata kushtetuese sipas së cilës kritere si shtetësia dhe vjetërsia e rezidencës përbëjnë elementë dallimi arbitrare nëse u referohen të drejtës për shërbime sociale që kanë për qëllim përfshirjen shoqërore".

Ndaj në dokumentin e tij, ASGI e quan "diskriminuese" iniciativën edhe sepse rezultoi "në kundërshtim me nenin 41 të tekstit unik të imigracionit" që disiplinon parimin e barazisë në trajtim lidhur me asistencën sociale në atyre që kanë kartë qëndrimi apo leje qëndrimi të paktën njëvjeçare.

M.I.

gjithnjë ka thënë se donte veç të ndihmonte fqinj e tij.

Përpara gjykatësit, ka shpjeguar avokati, Antonio D'Orzi, Ndreu "ka nisur të qajë e ka shpjeguar se përpiquej vetëm t'i jepte një dorë Gomilës, që jetonte në Castelfiorentino përballë shtëpisë së tij, ka tre fëmijë e që prej kohësh i kërkonte t'i jepte punë për të fituar ndonjë para". Ndreu ka shpjeguar gjithashtu se është artica i thjeshtë, në sektorin e izolimit të çatave dhe që punon vetëm. Sipas rrëfimit të tij, ditën e tragjedisë kishte marrë me vete Gamilën për të transportuar ca materiale që do t'i duheshin për punën që do të kryente në kapon.

Gjithsesi mbi Renato Ndreun rëndojnë akoma akuzat e rënda të vrasjes nga pakujdesia, punësimit të klandestinëve dhe të mosrespektimit të normave të sigurisë në vendin e punës

Aksident rrugor Humb jetën 38 vjeçari Vlasi

Durim Vlasi humb kontrollin e makinës, përplasjet me një rrap. Aksidenti në 3 të mëngjesit, në fshatin Villorba të Trevisos. Ndërron jetë teksa e çonin në spital

Shpejtësia e lartë, makina që del nga kontrolli dhe përplasja e fortë pas një rripi. Kjo ka ndodhur pak a shumë në 3 të natës duke gdhirë 28 gushti në lokalitetin Venturali të Villorbas në provincën e Trevisos, aksidenti në të cilin ka gjetur vdekjen shoferi, Durim Vlasi, një shqiptar 38 vjeç që jetonte në

Treviso.

Sipas policisë rrugore që ka shkuar në vendngjarje bashkë me zjarrfikësit, Vlasi vinte nga Spresiano në drejtim të Trevisos. Ajo pjesë e rrugës është e drejtë dhe veçanërisht në atë orë të natës që nuk ka trafik, të fton t'ia shkelësh gazit. Vështirë të thuhet çfarë ka shkatëruar aksidentin, ndoshta

e ka zënë gjumi apo ka pasur ndonjë shqetësim të papritur shëndetësor, fakt është që për një çast makina i ka dalë nga kontrolli. Fiat Punto i Vlashit ka dalë nga rrua dhe është përplasur me një nga rrapet buzë saj. Në përplasje 38 vjeçari ka marrë plagë të rënda dhe ka ndërruar jetë në ambulancën që po e çonte në spital.

Rugolo per eni

deri në 100 euro në bonus karburanti falas po të zgjedhësh **LINK** në eni.com



kalo në eni gas e luce brenda 15 shtatorit
dhe me paketën link në sitin eni.com do të kesh:

- bonuse karburanti elektronike prej **50 eurosh** për nënshkrimin e një projekt **link** për gazin apo energjinë elektrike
 - bonuse karburanti elektronike prej **100 eurosh** për nënshkrimin e një projekt **link** për gazin dhe energjinë elektrike
- Bonuset e karburantit mund të shpenzohen pranë stacioneve **eni** ose **agip** që aderojnë.

Bonuset mund të përdoren, pas aktivizimit, brenda 24 muajve duke filluar nga 15/12/2011. Informacione dhe rregullore në eni.com

eni gas e luce zgjidhja më e thjeshtë



eni

Uhap më 31 gusht edicioni i 68-të i Festivalit ndërkombëtar të kinematografisë së Venecias që mes filmave të shumtë në konkurs ka në garë edhe filma dedikuar temës së imigracionit.

Më 5 shtator është radha e "boat-people". Një varkë që do të mbërrijë mbi tapetin e kuq të Lagunës me imigrantët e saj nga Senegali, Bregu i Fildishtë dhe Benini. Është e veçantë gjetja promotionale e regjisorit Guido Lombardi për të prezantuar filmin e tij "Là-bas-Educazione criminale".

Filmi italian, i vetmi në garë në seksionin "Settimana della Critica", rrëfen ditët dramatike të dhunës ndaj imigrantëve zezakë në Castel Volturno. Në qendër të filmit është historia e një të riu jokomunitar që vjen në Itali plot shpresë por të cilit i duhet të përballet me përditshmërinë e vështirë dhe të egër.

Gjithnjë mbi temën e imigracionit, por jo në konkurrim, është filmi i Ermanno Olmit "Il villaggio di cartone" i cili denoncon një humanitet gjithnjë e më pak vlera e solidaritet ku "të braktisurit e vërtete të Ungjillit janë tashmë imigrantët".

Pritje e ethshme për "Terraferma" në garë për çmimin "Leone d'Oro 2011" të Emanuele Crialeses që trajton temën e imigracionit dhe të përbaljes së kulturave të ndryshme. Filmi, që shfaqet më 4 dhe 5 shtator në Venecia, dhe nga 7 shtatori në sallat e kinemave, rrëfen miqësinë mes dy grave: njëra lampezana të cilës i ka vdekur burri në det dhe tjetra klandestine në arrati. E gjithë kjo në ishullin e Lampedusas të ndarë



IMIGRANTËT zbarkojnë në VENEZIA

Janë protagonistët e filmave të Festivalit të 68-të të Filmit. Të filmit "Là-bas" i regjisorit Guido Lombardi, "Terraferma" i Emanuele Crialeses, "Cose dell'altro mondo" i Francesco Patierno



”

Abadantuono përdor mjetet e komunikimit që disponon për të predikuar idetë e tij mbi një botë pa të huajt dhe mbi padobinë e tyre në shoqërinë italiane duke ulërirë slogane si "Bashkëjetojmë me fundamentalistë islamikë, arrixhinj, shqiptarë të ndyrë: merrni devenë e kthehuni në shtëpi!"

dysh mes dëshirës për turizëm dhe frikës së zbarkimeve.

I pranishëm në seksionin "Controcampo italiano" (ku konkurrojnë tendencat e reja të kinematografisë italiane) do të jetë filmi i shumë përfolur i

Francesco Piaternos, "Cose dell'altro mondo", me protagonist Diego Abadantuono-n në petkun e një sipërmarrësi racist dhe pronar i një televizioni privat në veri-lindje të Italisë

Polemika të shumta janë ndezur në web rreth filmit nga qytetarë të krahinës Veneto. Në film (me titull "Çështje të një tjetër bote"), Abadantuono përdor mjetet e komunikimit që disponon për të predikuar idetë e tij mbi një botë pa të huajt dhe mbi padobinë e tyre në shoqërinë italiane duke ulërirë slogane si "Bashkëjetojmë me fundamentalistë islamikë, arrixhinj, shqiptarë të ndyrë: merrni devenë e kthehuni në shtëpi!"

Dhe një ditë të bukur, lutjet e sipërmarrësit Abadantuono bëhen plotësohen dhe papritur e pa kujtuar, nga qyteti i vogël ku jeton zhduken të gjithë jokomunitarët. Duke nxjerrë kështu në dukje nevojën e pranisë së imigrantëve si dhe rëndësinë e tyre në tregun e punës.

Por paraqitja e Venetos si krahinë raciste dhe ksenofovenuk u pëlqen italianëve të veri-lindjes së Italisë që qoftë gjatë xhirimeve, qoftë në paraqitjen e filmit në fillim të gushtit, kanë protestuar ashpër e kanë kërkuar me forcë "bojkotoni filmin!" që e konsiderojnë fyes dhe racist.

Edhe ndonjë nga administruesit vendorë nuk ka pasur ide shumë të ndryshme nga banorët, aq sa kryetari i komunës së Trevisos, për shembull, nuk i dha mundësi trupës të xhironte në

qytet disa skena, leje që ia dha, për shembull, kryetari i komunës Bassano del Grappa.

Për regjisorin Patierno, gjithë këto polemika nuk janë veçse tregues të faktit që "ka vënë gishtin në plagë".

E me gjithë polemikat e ashpra të gushtit, "Cose dell'altro mondo", është njohur nga ministria e Kulturës si film me interes kulturor kombëtar. Tashmë, nga 3 shtatori po shfaqet në kinema për publikun e gjerë.

Më 31 gusht festivalin e hapi George Clooneyt, me "The Ides of March", filmi i tij i katërt si regjisor ku edhe luan edhe si aktor. Filmi, me Ryan Gosling, Philip Seymour Hoffman, Paul Giamatti, flet për një të ri idealist, ekspert komunikimi, në shërbim të Guvernatorit Morris në garën e për president i ShBA-së, të përfshirë dashje pa dashje në çështje korupsioni.

Në garë për Luanin e Artë, që jepet më 10 shtator, janë njëzetetë filma. Figura të njohura të kinemasë botërore do të konkurrojnë për çmimin e madh, si kanadezi, David Cronenberg ("A dangerous method"), regjisorin nga Hong Kongu, Johnnie To ("Life without principle"), rusi Alexandre Sokurov ("Faust") dhe amerikani, Todd Solondz ("Dark Horse"). Por edhe autorë të rinj si Andrea Arnold ("Wuthering Heights"), Ami Canaan Mann ("Texas Killing Fields"), Steve McQueen ("Shame").

Ky Festival i 68-të shënon gjithashtu rikthimin e Abel Ferrarës me një film mbi fundin e botës: "4:44 Last Day On Earth" dhe atë të William Friedkin, me "Killer Joe".



Italianët e rinj në botërorin e atletikës

Në delegacionin italian në Korenë e Jugut edhe katër italianë me mbiemër të huaj. Por për të rinjtë e brezit të dytë mbetet ende e vështirë të veshin fanellën italiane. E di mirë shqiptari Eusebio Haliti

Ka edhe italianë të rinj në kampionatin botëror të atletikës së lehtë që nisi më 27 gusht në Daegu, në Korenë e Jugut.

Jean-Jacques Nkouloukidi, me baba kongolez dhe nënë haitiane, është 19-vjeçar i rritur në Ostia të Romës dhe dot përfaqësues i Italisë në garën e 50 km marshim. Padyshim më e shpejtë është gara e Jacques Riparelli, 18-vjeçar me baba italiane nënë nga Kameruni, që jeton që kur ishte i vogël në provincën e Venecias dhe do të marrë pjesë në stafetën 4x400.

Mes atleteve vajza, hedhja e shtizës shpreson te Zahra Bani, vajzë e një italian dhe një somalezjeje, e lindur 31 vjet më parë në Mogadisho dhe që jeton në Giaveno të Torinos që kur ishte dhjetë vjeç. Ndërsa 28-vjeçarja Libania Grenot Martinez, italo-kubane që ka marrë shtetësinë italiane për martesë, do të jetë në pistë për stafetën 4x400.



Eusebio Haliti

Nuk është për t'u çuditur që në delegacionin e kaltër ka vetëm një atlet me të dy prindërit imigrantë të huaj, me gjithë numrin e lartë të të rinjve të brezit të dytë që praktikojnë sportin në Itali, edhe në nivel profesionistësh. Problemi është

që për shumicën dërrmuese të tyre, të bëhen italianë është shumë e vështirë, për shkak të ligjit të shtetësisë.

E nje mirë këtë problem Eusebio Haliti, 19 vjeç kampion italian i të rinjve në 400 metra indor dhe në pistë. Ka lindur në Shqipëri dhe jeton në Itali që prej vitit 2000 por vetëm nga 2002-shi është regjistruar si rezident në komunë: kështu që mund të kërkojë shtetësinë italiane vetëm në vitin 2012, tepër vonë për të realizuar ëndrrën e tij që të marrë pjesë në olimpiadën e Londrës me fanellën e Italisë.

Rasti i tij ka përfunduar deri në Parlament, kur pak javë më parë deputetët e PD-së Francesco Boccia dhe Michele Ventura i kanë kërkuar qeverisë të mos diskriminojnë të rinjtë, që "edhe pse kanë lindur apo janë rritur në Itali dhe ndihen italianë, konsiderohen gjithsesi të huaj".

Elvio Pasca

SHQIPËRIA ËSHTË GJITHNJË MË PRANË.



CALL YOUR COUNTRY

FLET ME SHQIPËRINË ME 5 QINDARKA NË MINUTË ME NUMRAT E RRJETIT FIKS,
10 QINDARKA NË MINUTË ME CELULARËT.
FALAS NË PROMOVIM KOSTOJA SEMESTRALE PËR 6 MUAJT E PARË.

DHE ME **SUPER NOI WIND** ÇDO JAVË
KE 400 MINUTA DHE 400 SMS E MMS ME TË GJITHË NUMRAT WIND
ME VETËM 3€ NË JAVË DHE PA KOSTO AKTIVIZIMI.



AKTIVIZO CALL YOUR COUNTRY
ME NJË SMS FALAS
DUKE INKUADRUAR KODIN
ME SMARTPHONE-N TËND



AKTIVIZO SUPER NOI WIND
ME NJË SMS FALAS
DUKE INKUADRUAR KODIN
ME SMARTPHONE-N TËND

Zgjidh Wind. Duke telefonuar në 155, dëgjon risitë dhe merr asistencë në gjuhën shqipe.
PËR MË SHUMË INFORMACIONE MBI KOSTOT, KUSHTET DHE KUFIZIMET, SHKO NË WIND.IT

Call Your Country: Shkëmbje në përgjigje 16 cent. Tarifimi çdo 60 sekonda. Kosto semestrale 4€. Për klientët e rinj aktivizimi i Call Your Country 7€, falas deri më 2/10/2011. Super Noi Wind është në vlerë për telefonatat drejt numrave Wind në Itali.


WIND
Più vicini.



Foto Vittorio Arcieri

MEDALJE PËR FERRAGOSTO

Nga Ardian VEHBIU

Sikurse u njoftua në shtyp, Presidenti i Republikës Shqiptare Bamir Topi vizitoi ditët e para të gushtit qytetin e Barit, në Itali, ku edhe dekoroi, ndër të tjera, Komunën e Barit me "Medaljen e Mirënjohjes".

Në ceremoninë e dekorimit, Presidenti ndër të tjera tha:

Është një kënaqësi e veçantë për mua që të marr pjesë në këtë aktivitet për të përkujtuar një ngjarje të rëndësishme në memorien e dy vendeve tona mike, Italisë dhe Shqipërisë. Ky është 20-vjetori i mbërritjes në portin e Barit të anijes "Vlora", në bordin e së cilës ishin futur mijëra emigrantë shqiptarë, dhe emocionet vazhdojnë dhe pas 20 vitesh, që ëndërronin një jetë më të mirë, duke lënë pas regjimin totalitar, dhe duke gjetur tek populli i Pulias dhe i Barit, si dhe tek autoritetet italiane një mikpritje dhe solidaritet të madh njerëzor, të paharrueshëm për të gjithë shqiptarët.

Medalja u dha me këtë motivacion:

Me mirënjohje të thellë Komunës së Barit dhe gjithë popullit të Rajonit të Puljas, për solidaritetin e rrallë dhe përkrahjen e pakufishme që i dhanë në momente të vështira dhe dramatike, 20 vjet më parë, mijëra qytetarëve shqiptarë që mbërritën në Portin e Barit, në kërkim të një jete më të mirë.

Ndonjë komentator, në mediat e afërta me qeverinë, vuri në dukje se nuk kishte asnjë arsye për këtë dekorim, meqë ngjarjet dhe incidentet e 20 vjetëve më parë, në gusht të vitit 1991 në portin e Barit, kanë shkruar një nga faqet me të zeza dhe më të turpshme të marrëdhënieve italo-shqiptare.

Meqë kam qenë vetë në Itali në ato kohë dhe i kam ndjekur nga afër incidentet me refugjatët shqiptarë, më duhet të pranoj se mbeta gojëhapur me gjestin e Presidentit Topi.

Sikurse nuk është sekret, ka pasur dy

Sikurse u njoftua në shtyp, Presidenti i Republikës Shqiptare Bamir Topi vizitoi ditët e para të gushtit qytetin e Barit, ku edhe dekoroi, ndër të tjera, Komunën e Barit me "Medaljen e Mirënjohjes".

Ka pasur dy valë të mëdha refugjatësh shqiptarë drejt Italisë: në mars të vitit 1991 dhe në gusht të vitit 1991. Ekzodi i dytë, në mes të stinës turistike verore, u shoqërua me masa të rrepta kundër të ardhurve, të cilët i mbyllën me forcë në stadiumin e vjetër të Barit, ku i lanë të piqen në diell me ditë të tëra; pastaj i nxorën që andej dhe, me dredhi, i riatdhësuan me urë ajrore.

Për fat të keq, në fjalën e vet, Presidenti Topi i referohet shprehimisht mbërritjes në Bari të anijes "Vlora" të ngarkuar me refugjatë në gusht të 20 vjetëve më parë, çka ia largon lexuesit çdo dyshim: ai u shpreh mirënjohjen autoriteteve italiane për një fiasko që, këto vetë, do të kishin dashur ta harronin.

valë të mëdha refugjatësh shqiptarë drejt Italisë: në mars të vitit 1991 dhe në gusht të vitit 1991. Nëse komuna e Barit duhej dekoruar patjetër, kjo duhej bërë për pritjen e mirë që iu bë refugjatëve në mars, ose gjatë ekzodit të parë.

Përkundrazi, ekzodi i dytë, në mes të stinës turistike verore, u shoqërua me masa të rrepta kundër të ardhurve, të cilët i mbyllën me forcë në stadiumin e vjetër të Barit, ku i lanë të piqen në diell me ditë të tëra; pastaj i nxorën që andej dhe, me dredhi, i riatdhësuan me urë ajrore.

Askush nuk mendon të bëjë me faj autoritetet e komunës së Barit për këtë krahurë humanitare; vendimet merreshin në instancat më të larta të shtetit italian; sepse kriza e shkaktuar prej refugjatëve kishte përmasa kombëtare. Pas vështirësive të marsit 1991, qeverisë italiane i mungonte edhe vullneti politik edhe logjistika, për t'i bërë ballë këtij ekzodi të dytë njëlloj si të parit, ose duke i përthithur refugjatët në qendrat e strehimit të përkohshëm; në një kohë që edhe vetë opinioni pub-

lik ishte kundër një ndërmarrjeje të tillë.

Për fat të keq, në fjalën e vet, Presidenti Topi i referohet shprehimisht mbërritjes në Bari të anijes "Vlora" të ngarkuar me refugjatë në gusht të 20 vjetëve më parë, çka ia largon lexuesit çdo dyshim: ai u shpreh mirënjohjen autoriteteve italiane për një fiasko që, këto vetë, do të kishin dashur ta harronin.

Nuk dua të spekuloj shumë për arsyet e këtij gabimi, të cilin duhej ta kishin kapur, të paktën, këshilltarët e Presidentit. Ndërkohë, po sjell këtu disa fragmente nga libri *La Scoperta dell'Albania*, Edizioni Paoline 1996, që kemi shkruar së bashku me Rando Devolen dhe ku jemi ndalur, ndër të tjera, edhe në mënyrën si i trajtoi shtypi italian incidentet me refugjatët gjatë atyre ditëve të nxehta të gushtit 1991. Edhe pse libri nuk është kronikë, as histori e dyndjeve të shqiptarëve drejt brigjeve të Italisë në ato vite, materiali në vijim përmban aq citime dhe referime autentike, sa të provojë se kjo medalje nuk duhej dhënë.

Fragmentet e mëposhtme i kam nxjerrë nga një përkthim imi i një kapitulli të librit, i cili u botua vjet në Revistën *Përpyekja* (26-27).

[...]

Në ditët e para të gushtit 1991, gjendja e jashtëzakonshme për shkak të refugjatëve kthehet sërisht në plan të parë: eksodi po përsëritet dhe anijet e mbushura me shqiptarë po u afrohen edhe një herë tjetër brigjeve të Puglias.

Gazetat japin alarmin me tituj të kumbueshëm: "Pushtimi shqiptar", "Kthehen të dëshpëruarit e detit" (*La Repubblica*, 8 gusht 1991), "Shqiptarët, eksod bibliq" (*Il Giornale*, 9 gusht 1991). Sikur të ndiqnin ndonjë skenar, përsëriten "skenat apokaliptike", në një "atmosferë hysterie kolektive", me "imazhet halucinante" të "anijeve që shfaqen kudo" e të "çurgave njerëzore që rrjedhin prej mureve të anijeve." Të sapoardhurit, me "fytyra të drobitura, sy të përshkënditur nga lodhja dhe të pangrënit, flokë të gjatë e të shpupurit-

Nga Corrado GIUSTINIANI

Historia e harruar e anijes VLORA

Më 8 gusht 1991, anija shqiptare e mallrave Vlora, mbërriti në portin e Barit, e tejmbushur me refugjatë nga Shqipëria. Autoritetet e qytetit dhe rajonit, me mbështetjen e agjencive të lajmeve, gazetave lokale e jo lokale apo lajmeve televizive, përkujtuan ngjarjen si një lloj feste të ndjenjës së mirëpritjes, tanimë e humbur.

Por ngjarjet kanë pasur një rrjedhë të ndryshme: imigrantët fillimisht u mbyllën në stadiumin e vjetër Della Vittoria, dhe më pas u riadhesuan për në Shqipëri. Gjendje shëndetësore e mjeteve tona të komunikimit duhet të jetë e lëkundur deri sa dembelizmi pengon rindërtimin e ngjarjeve, të bujshme, që kanë ndodhur vetëm njëzet vjet më parë. Le të shohim pra se kanë shkuar gjërat, duke ndjekur kronikat e asaj kohe.

Anija Vlora, mbërrin nga Durrësi, gati pa karburant, mundohet të hedhe spirancën në Brindisi, por nuk pranohet dhe drejtohet për në Bari. Në bord ka edhe njerëz të armatosur, përveç imigrantëve në arrati nga 45 vjet regjimi komunist, tanimë i shkërmoqur, ka dhe gra e fëmijë. Komandanti Halim Milaqui i rrëfen gazetarin Antonio Padalino të revistës Panorama se anija e tij kishte mbërritur në port nga Kuba, plot me sheqer, dhe shkarkimi i saj nuk kishte përfunduar akoma, kur e pa që po afrohej ky det njerëzish. Atëherë jep urdhër që të fillojë lundrimi, por disa milicë, që kanë arritur të hipin, i vënë një thikë në fyt dhe e detyrojnë të kthehet prapa për të marrë të gjithë ata njerëz.

Sa janë në bord? Gazetat e 9 gusht 1991 shkruajnë për 11 000 persona, ndërsa në kronikat e sotme flitet për 20.000. Një gjë është e sigurt, ishte një mori mbresëlënëse njerëzish, e shumë prej tyre ishin kapur edhe në shtizën e flamurit. Fotografitë e Luca Turi dhe Vittorio Arcieri janë tronditëse dhe kanë përjetësuar edhe njerëz që, pas mbërritjes në port, janë hedhur në ujë nga anija.

Në orën 11e 30 lumi i njerëzve ndodhet në platformë. Kërkojnë bukë dhe ujë. Vlora është kthyer në një nevojtoje me erë të keqe. Policia i drejton të gjithë në stadiumin e vjetër të futbollit, ne pritje të vendimeve.

Kryeministri, Giulio Andreotti, dikton nga Roma këtë deklaratë: "Nuk jemi absolutisht në gjendje të mirëpresim shqiptarët që po dynden në brigjet italiane dhe vetë qeveria e Tiranës është

Më 8 gusht 1991, anija Vlora mbërriti në portin e Barit.

Më 8 gusht 2011, autoritetet e qytetit dhe rajonit, me mbështetjen e agjencive të lajmeve, gazetave lokale e jo lokale apo lajmeve televizive, përkujtuan ngjarjen si një lloj feste të ndjenjës së mirëpritjes, tanimë e humbur.

Tre ditë më parë, presidenti i Shqipërisë Bamir Topi i dorëzoi kryetarit të Bashkisë së Barit, Michele Emiliano, "Medaljen e Mirënjohjes", me motivimin: "Me mirënjohje të thellë Komunës së Barit dhe gjithë popullit të Krahinës së Puljas, për solidaritetin e rrallë dhe përkrahjen e pakufishme që i dhanë në momente të vështira dhe dramatike, 20 vjet më parë, mijëra qytetarëve shqiptarë që mbërritën në Portin e Barit, në kërkim të një jete më të mirë".

Por historia e anijes Vlora ishte një tjetër...



dakord me ne që ata duhet të riadhesohen në vendin e tyre" Në stadium plas revolta.

Më të rinjtë shkulin pllakat e shkallëve dhe hedhin gurë kundër policisë. Përleshje të ashpra zgjatën tre ditë, më të dhunshmet qenë ato të së dielës, më 11 gusht, me 40 të plagosur mes policisë dhe një numër i pacaktuar mes protestuesve.

Shqiptarëve u jepet ushqimi dhe uji nga qielli, më thasë të hedhur nga helikopterët. Janë skena Apokalipsi. Ndërkohë organizohet operacioni më i madh i riadhesimit në historinë e republikës. Në të marrin pjesë 11 avionë ushtarakë C130 dhe G222, së bashku me tre Super80 të Alitalia-s dhe motobarka si Tiepolo, Palladio dhe Tiziano, në të cilën hipën klandestin gazetari i Il Messaggero Marco Guidi. Ai u hoq si shqiptar për të mund të njohur historitë e imigrantëve. Në fillim shumë prej tyre nuk e dinë se po i kthejnë. "Është e vërtetë që do na çoni në Venecia?" pyet njëri ekuipazhin, sipas rrëfimit të Marco Guidi.

Të riadhesuarit qenë 17 mijë e 400, më shumë nga pasagjerët e Vlorës (e përsërisim sipas shifrave të asaj kohe), sepse u riadhesuan edhe imigrantë që kishin mbërritur me anije të tjera. Mbetën në Itali 1.500 vetë që kishin paraqitur kërkesë për stremitë politike.

Gianni De Michelis, ministër i Punëve të Jashtme, fluturoi për në Tiranë për të ilustruar një plan italian ndihme: 90 miliardë lireta për ushqime, 60 miliardë për industrinë dhe furnizimet për hapjen në tetor të shkollave, dhe bashkëpunim në rendin publik për të parandaluar ikje të tjera. Në Parlament pati polemika mbi metodat e rrepta, madje brutale, të këtij operacioni. Shumë më pak mbi thelbin e tij. Në një konferencë shtypi deputetët e Pds (Partia Demokratike e sotme) "megjithëse kuptojmë vendimin e dhimbshëm për riadhesimin e refugjatëve në Shqipëri" ata denoncuan "zgjedhjen e pamenduar për të mos respektuar të drejtat e njeriut, duke u mohuar atyre një asistencë të denjë."

Kjo është e vërteta e fakteve, që askush sot nuk mund t'i ndryshojë. Megjithatë, në ato vite, Italia në përgjithësi dhe Puglia në veçanti dhanë prova shumë të mëdha mikpritjeje. Më pas mes Romës dhe Tiranës do të lidhet një marrëveshje model, e cila arriti të lehtësojë emigracionin e rregullt të të shumë shqiptarëve. Por historia e anijes Vlora është kjo.

Ilmessaggero.it - Albanesi tutti a casa. La vera storia della Vlora

8 GUSHT 1991 – 8 GUSHT 2011

Mbërritja e anijes Vlora me mbi 20 mijë shqiptarë në portin e Barit, më 8 gusht të vitit 1991, fotot e mrekullueshme të Luca Turit apo Vittorio Arcierit, filmimet e atyre ditëve, zunë ditët e para të gushtit të këtij viti hapësirë të gjerë në mediat italiane. I bëhet jehonë edhe medaljes që presidenti i Republikës së Shqipërisë Bamir Topi i jep qytetit të Barit.

Editioni i Barit i të përditshmes La Repubblica në faqe të parë kujton 20 vjetorin e mbërritjes së Vlorës në Bari me një shkrim të Antonio di Giacomo me titull "20 vjetët e Vlorës. Nderime për kryebashkiakun Dalfino", një video-intervistë me Kledi Kadriu, që në Itali ka ardhur

20 VJETORI I EKSODIT NË MEDIAT ITALIANE

për herë të parë pikërisht me anijen Vlora, si edhe artikullin e Cristiano Martit me titull "Vlora, Barit Medalja e mirënjohjes. Topi: 'Nuk do të harrojmë kurrë ndihmën tuaj'".

Revista e përjavshme Famiglia Cristiana, në përvjetorin e mbërritjes së Vlorës në brigjet e Barit, gjen rastin të flasë për tragjedinë e të Premtes së shenjtë të 1997-ës. Në shkrimin "Otranto, një dhimbje për t'u kujtuar" kujton fundosjen e Katër i Radës

që u mori jetën 108 vetëve si edhe për përpjekjet e sotme Integra Onlus me kryetare Klodiana Çuka dhe të kryebashkiakut të Otrantos, Luciano Cariddi, për ta kthyer relikthin në një monument në kujtim të të gjitha viktimave të detit.

Gazzetta di Mezzogiorno ka në faqen e saj të parë në web tre artikuj mbi eksodin e gushtit 1991. Raffaele Nigro, dëshmitar i asaj kohe sot shkruan "Vlora, në atë anije njerëz në kërkim të shpagim-

it". "Duhet 'u jepnim një dorë – shkruan – siç bëri populli i Barit, kryebashkiaku Dalfino, apo imzot Tonino Bello, ndërsa ministri i Brendshëm i asokohe i mbylli në stadium, vendosi t'u jepte për të ngrënë duke u hedhur panine nga helikopteri e të përdorte hidrantët për t'i larë".

Ndërsa Renato Brucoli në shkrimin me titull "Ato dy motra të pikasura nga dom Tonino në ferrin e Vlorës" rrëfen ç'ka parë me sytë e tij në stadiumin e Barit ku shkon bashkë me dom Tonino Bello. "E kujtoj shumë mirë atë çast dalldie... – shkruan mes të tjerash – Barka plot njerëz në rragim vazhdojnë të mbërrijnë edhe sot. jo më në Bari, por në Lampedusa. Kanë kaluar 20 vjet".

Më 5 gusht, Corriere di Mezzogiorno, me artikullin "Dhe 20 mijë të dëshpëruarit u kthyen në të burgosur. Zbarkimi i Vlorës 20 vjet më parë" kujton rrjedhën e ngjarjeve të atyre ditëve, odisenë e mëse 20 mijë shqiptarëve, stadiumin, gënjeshtret e shtetit italian. Më 6 gusht, e njëjta gazetë boton intervistën me Bamir Topin "Bari, porta jonë për në Europë". Krah saj edhe prononcimin e Governorit të Puglias, Nicki Vendola, që duke krahasuar mikpritjen e 20 vjetëve më parë me atë të sotmen ndaj afrikanëve sot në brigjet e Lampedusas thotë "Pas 20 vjetëve, gjërat janë përkeqësuar".

(ke.bi)



A I KE SHTATË
LIQENET E LURËS
NË KOPËSHT?



SIGNORINA,
UNA
SCHEDINA!

MUND
TË FITOSH
JACKPOTIN
MILIONER.



SuperEnalotto 

ËNDËRRIMTAR LIND,
MILIONER BËHESH.



Nëse nuk ke mbushur 18 vjeç, nuk mund të luash.

vijon në faqen 11

ur, duket sikur janë arratisur nga ndonjë kamp përqendrimi. Pa e ditur se këtu do t'i priste një kamp tjetër [...]. Gjithë ditën e ditës, nën një diell të pamposhtur, ecin këmbëzbathur mbi asfaltin e zbutur nga zhegu [...] në kolona që të bëjnë të përfytyrosh një gjykim universal të parakohshëm" (Barbara Palombelli, *La Repubblica*, 9 gusht 1991).

Një mjek shpjegon: "janë skelete të gjalla, të plagosur, të dehidratuar, të uritur dhe jo vetëm për shkak të udhëtimit dyditor... Të tillë njerëz kam parë vetëm në filmat për Vietnamin" (*La Repubblica*, 10 gusht 1991). "Në krahasim me valën e parë, tani shoh më shumë gra, më shumë fëmijë, madje familje të tëra. Parakalojnë këmbëzbathur dëshmitarët e një shoqërie që po shpërbëhet: fshatarë, mësues, teknikë, ushtarakë, madje edhe kampionë sporti" (Massimo Nava, *Corriere della sera*, 9 gusht 1991).

Kronikat e të dërguarve të gazetave mbushen me dhunë, përdhunime, të vjella, gjak, goditje thikash, plagë, të shtëna, djersë, fëmijë që lëngojnë; ka madje edhe një "të vdekur në hambar të anijes", si për të plotësuar kuadrin. Në *Corriere della sera*, Enzo Biagi flet për "një mizëri ditëzinjsh me brekë" (12 gusht 1991).

[...]
Në gusht 1991 gjendja shëndetësore nisi të pikturohej me ngjyra edhe më të errëta e me tone edhe më apokaliptike. Edhe një herë, mbërritja e turmave në Bari ngriti nga varri mitin stërgjyshor të Tjetrit si sjellës sëmundjesh.

Në të vërtetë, këtë radhë refugjatët shqiptarë e panë veten në rrethana shëndetësore shumë të rënda: u grumbulluan me forcë në një stadium, për t'u lënë atje të kequshqyer, pa ujë e pa shërbime sanitare, nën diellin djegës të verës mesdhetare.

Megjithatë, miti nuk u mjaftua me aq. Sëmundjen mediat italiane nisën ta shohin si ndonjë cilësi intrinseke të refugjatëve, deri në atë shkallë sa pasojat e udhëtimit në kushte çnjerëzore në hambarët e anijeve dhe të trajtimit më pas në tokën italiane u interpretuan si shenja të qarta zakonesh higjienike të këqija.

"Buletinet mjekësore flasin... për raste të shumta zgjebeje, infeksionesh të lëkurës, gastroenteriti dhe krizash të abstinencës nga toksikodipendentët" (*Il Giornale*, 11 gusht 1991).

Një mjek që inspekton anijen "Vlora" konstaton "me dhjetëra hemorragji që u detyrohen dështimeve spontane" (*La Repubblica*, 9 gusht), ndërsa forcat e rendit flasin për "sëmundje të shqiptarëve, që nuk ua zë dot emrin në gojë" (*La Repubblica*, 10 gusht).

[...]
Të mbyllur në stadium, shqiptarët arrinin, gjithsesi, t'ia dërgonin botës një mesazh të tyrin të drejtpërdrejtë, me natyrë olfaktive: "Kurrë mos iu afroni stadiumit në drejtim të kundërt me erën. Dalin që andej duhma kutërbuese, si të kishte brenda këрма të qelbura." (Beppe Gualazzino, *Il Giornale* 14 gusht 1991).

MEDALJE PËR FERRAGOSTO

nga Ardian VEHBUI



Veç kësaj, shumë lehtë mund të kalohet nga frika ndaj sëmundjeve në frikën ndaj ndotjes - jo vetëm nga mikrobet, por edhe nga modele sociale dhe të sjelljes që mund të vënë në rrezik baraspeshën sociale, mbi të cilën themelohet identiteti i qytetarit perëndimor.

[...]
Kur shqiptarët nisën dyndjen e dytë drejt Italisë në gusht të vitit 1991, u duk qartë se autoritetet italiane u kapën sërish të papërgatitur nga vala e re e refugjatëve. Pas një vendimi që më pas u kritikua rëndë, mijëra të ikur u çuan ("deportuan" ishte termi i përdorur nga të dërguarit e mediave) në stadiumin e vjetër të Barit, në pritje të përfundimit të procedurave të riatdhëimit.

Afrimi i stadiumit me kampin e

përqendrimit nuk shmanget dot; në komentet e hidhura të gazetave nxjerr krye shpesh krahasimi me ngjarjet në Kilin e Pinochet-it; ndonjë tjetër kujton stadiumin "Roland Garros" në Paris, i cili u përdor në mënyrë të ngjashme nga nazistët gjatë Luftës II Botërore.

Çfarë ndodhi pastaj në stadium ka mbetur, në disa aspekte, mister sot e kësaj dite. Të braktisur nën diellin përzhitës të gushtit, pa shërbime sanitare, pa ujë (me përjashtim të çka u vinte prej zorrëve të zjarfikësve), të ushqyer prej helikopterëve dhe të ftuar, pa pushim, nëpërmjet megafonave të policisë, që t'u dorëzoheshin autoriteteve për t'u kthyer pastaj në atdhe, refugjatët prej Shqipërie nisin një luftë prej të dëshpëruarish që të mbeten në Itali.



“ Afrimi i stadiumit me kampin e përqendrimit nuk shmanget dot. Ndonjë kujton stadiumin "Roland Garros" në Paris, i cili u përdor në mënyrë të ngjashme nga nazistët gjatë Luftës II Botërore. Të braktisur nën diellin përzhitës të gushtit, pa shërbime sanitare, pa ujë (me përjashtim të çka u vinte prej zorrëve të zjarfikësve), të ushqyer prej helikopterëve dhe të ftuar, pa pushim, nëpërmjet megafonave të policisë, që t'u dorëzoheshin autoriteteve për t'u kthyer pastaj në atdhe, refugjatët prej Shqipërie nisin një luftë prej të dëshpëruarish që të mbeten në Itali.

Titujt e gazetave flasin qartë: "Revoltë në stadiumin kamp përqendrimi", "Beteja e Bari-t" (*La Repubblica*, 9 gusht). Shkruan Barbara Palombelli: "Zanati i të jetuarit për më shumë se 12 000 shqiptarë [...] nuk përshkruhet dot. Kush thyen këmbën duke kapërcyer murin, kush fut një shtizë çorapesh në vaginë, pritjet me thikë që të përgjaket aq sa të mundet [...]; kush tjetër nuk i përmend fëmijët që kanë humbur vetëdijen nga etja, por parapëlqen t'i lërë ashtu me orë të tëra." Massimo Nava, në *Corriere della sera*, 9 gusht: "Europa pa mure dhe pa kufij do ta kujtojë gjithnjë ndëshkimin e pafund të këtij kampi përqendrimi. Nga ekranet e TV-së, Italia tekta përgatitet për pushimet verore ndjek imazhe vuajtjesh të llahtarshme, aq sa e ka të vështirë të besojë se gjithë kjo është duke ndodhur pikërisht këtu."

Në një editorial me titull "Surpriza e hidhur nga Tirana" (*La Stampa*, 9 gusht 1991) Lorenzo Mondo vëren: "Do të na mbeten për shumë kohë në mendje imazhet e fundit të dramës shqiptare. [...] Stadiumi i shndërruar në kafaz, ku mijëra vetë kërkojnë nën diellin përvëlues një shishe ujë tekta përgatitjen arratisjen e dëshpëruar nëpër rrugët e Barit, skandalisht të tendosur midis pafajësisë dhe arrogancës... Janë ngjarje që ngjallin mëshirë, frikë dhe zemërim."

Pas vuajtjes, ia beh dhuna: po pse vallë? "Një dyshim endet në mendjet e forcave të rendit: refugjatët janë, në masë të madhe, ish të burgosur" (*La Repubblica*, 9 gusht). Ndërsa *Corriere della sera* i 10 gushtit: "të katandisur si bishat në kafaz, refugjatët janë të frikshëm. Janë vandalë të xhindosur."

Ndërkohë, pas dy-tre ditësh me traktativa që nuk çuan gjëkund, gjendja



faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.



bëhet vërtet kritike. Bërthama e fortë e të mbyllurve në stadium përgatiten për një luftë pozicioni me këdo që do të orvatet t'i nxjerrë nga strofka ku janë futur.

Po cilët janë këta të paepur, të cilët nuk ngurrojnë t'i shpallin luftë po atij shteti, të cilët vetëm pak ditë më parë i kishin trokitur në derë? *La Repubblica*, 14 gusht (titull në f. 2): "Tridhjetë gangsterë nga Tirana janë në krye të revoltës; nuk janë të gjithë kriminelë, madje mes tyre do të ketë edhe agjentë të Sigurimit." Pastaj vazhdon: "Mes të paepurve, bëjnë ligjin dy skuadra të organizuara mirë: njëra nga Durrësi dhe tjetra, më e organizuara e më e fuqishmja, e përbërë nga 30 djelmosha që vijnë të gjithë nga e njëjta lagje e Tiranës: Rruga Bardhyl. Diçka e ngjashme me një bandë huliganësh, një nga të shumtat që u formuan befasisht, në hapësirën midis shembjes së diktaturës dhe lindjes së ndrojtur të demokracisë."

Il Giornale e 11 gushtit parapëlqen një hipotezë tjetër: "Shqipëria - thuhet në rrugët e Barit - na ka dhuruar të droguarit, të marrët, të papërshtaturit. E bukura është se, për t'i marrë mbrapsht, kërkon edhe të shpërblehet" (Gianni Bucci). Më arsyetuese tingëllon *Il Giornale* e 15 gushtit: "Italianët gabuan kur vendosën të mbyllin një lukuni të egër njerëzish të dëshpëruar në stadium, duke e transformuar këtë, faktikisht, në një kamp përqendrimi kryengritës. Shqiptarët, nga ana e tyre, gabuan kur erdhën të kërkojnë mikpritje me leva, thika, armë zjarri; duke shkatërruar dhe vënë zjarre; duke sulmuar, si buajt të çmeritur, forcat tona të rendit, të duruara më tepër se ç'duhej."

Vëzhguesve të tjerë nuk u shpëtojnë detaje të dorës së dytë. Sipas Beppe Gualazzini-t, të *Il Giornale*, mes shqiptarëve të mbyllur në stadium ka "pallatistë të zotët dhe kaligrafistë" ("ITALIA, AIUTACI"), "përkthyes të zotët", "intendentë të zotët (kanë hequr mënjandë rreth 10 000 racione, për t'i bërë ballë rrethimit)", "ekspertë të gueriljes", "kapo që dinë të negociojnë me diplomaci të rrallë", madje edhe "tipa që janë në gjendje të përballojnë intervista të gjata në gjerman-

isht me një televizion të atyre anëve" (14 gusht).

Enigma vjen e thellohet edhe më, kur policia e pushton me dredhi fortesën stadium: "Deri dje, autoritetet i përshkruanin si 'bërthamë të fortë' të përbërë nga gangsterë dhe delinkuentë të zakonshëm; por tani u zbulua se pjesa më e madhe e tyre janë familje,



me gra dhe fëmijë" (*Il Giornale*, 15 gusht). Ja edhe trofetë që iu kapën ekspertëve të gueriljes, pas zbrazjes përfundimtare të stadiumit: (*La Stampa*, 13 gusht 1991): "pistoleta: 13, kallashnikov: 1, pushkë: 1, mushqetë: 1, thika: 16, sasi të mëdha municionesh".

[...] Problemi mund të shtrohet kështu: pse ndodhi gjithë kjo dhunë e kotë në stadiumin e Barit? Mos ishte vetëm një shpërthim zemërimi, pas ikjes së vështirë dhe plot sakrificë; ose një reagim i shpërpjesëtuar ndaj zhgënjimit dhe braktisjes? Apo mos ishte një dhunë "e importuar" nga Shqipëria, nëpërmjet gangsterëve të Rrugës Bardhyl dhe ish të burgosurve ordinerë; ose, më keq akoma, e provokuar nga agentët e policisë sekrete të diktaturës?

Teza e dytë, pas gjase, fitoi ndaj së parës dhe mbijetoi në trajtat e mitit, meqë fshihte në vetvete justifikimin për gjithçka të turpshme në Bari; dhe u mirëprit me psherëtima lehtësimi prej të gjithë atyre që ishin ndier në faj për çka kishte ndodhur. Dhunën institucionale ndaj kujt kishte kërkuar mikpritje në Itali dhe bindjen se nga

shkurtime]:

Gjatë ditëve të para të gushtit 1991, mijëra shqiptarë arritën në portin perëndimor të Durrësit dhe në portin jugor të Vlorës, me shpresë që të hipnin në anije dhe të largoheshin drejt Italisë.

Autoritetet shqiptare u orvatën më kot që të mos i lejonin qytetarët e tyre të largoheshin nga vendi, duke i vënë portet nën kontrollin e ushtrisë dhe duke ndaluar qarkullimin e trenave të pasagjerëve.

Në 8 gusht 1991, rreth 10,000 qytetarë shqiptarë të hipur në disa anije e çanë bllokadën dhe arritën në portin e Barit në juglindje të Italisë, dhe rreth 1,000 në portin e Otrantos. Gjithashtu, 675 shqiptarë në dy anije të tjera që provuan të zbarkonin pa sukses në Sicili, u devijuan drejt Maltës dhe më pas u kthyen në Shqipëri.

Pas disa orësh pritjeje në portin e Barit, autoritetet italiane i lejuan shqiptarët të zbrisnin nga anijet për arsye humanitare dhe i çuan në stadiumin La Vittoria. Ndërkohë që autoritetet italiane nisën riatdheshim të forcur me aeroplanë transporti ushtarak dhe tragete, pati përlëshje midis policëve italianë dhe shqiptarëve. Shqiptarët u barrikaduan në stadium dhe refuzuan të kthehen në vendin e tyre; rreth 300 prej tyre arritën të arratisen.

Autoritetet italiane u ofruan shqiptarëve 50,000 lireta për kokë (40 dollarë amerikanë) dhe roba të reja, nëse pranonin të ktheheshin në atdhe. Meqë kjo ofertë nuk i tërhoqi shqiptarët, vazhdoi riatdheshimi i tyre me forcë.

[...] Gjithë Europa i pa skenat dramatike, në lajmet televizive, që tregonin shqiptarët kur këta dëboheshin prej autoriteteve italiane. Megjithëse riatdheshimi ishte ligjërish i justifikuar, mënyra si u krye operacioni ishte problematike. Shumica e shqiptarëve, sipas rrëfimeve të tyre, kishin ikur nga atdheu sepse aty ndiheshin "të varrosur për së gjalli". Ata shpjeguan se, kur ishte hapur fjala se mund të largoheshin nga Shqipëria, hipën me forcë në kamionë dhe pastaj i detyruan ekipazhet e anijeve që t'i çonin në Itali. Kjo ishte një formë e psikozës kolektive. Është e vështirë të përcaktohet nëse kjo psikozë ishte shkaktuar qëllimisht apo jo, edhe pse pati zëra që e konfirmuan këtë.

Deportimi i shqiptarëve nga Italia u shoqërua me probleme dhe, në një numër rastesh, u desh ndërhyrja e policisë. Shqiptarët u shqetësuan veçanërisht kur morën vesh se, megjithë premtimet e autoriteteve italiane për t'i dërguar disa prej tyre në zona të ndryshme në Itali, ata u çuan drejt e në Shqipëri.

Duhet theksuar, megjithatë, se autoritetet italiane u dhanë shqiptarëve ushqim, veshje dhe pak parë.

Megjithëse pati shumë simpati për shqiptarët në Itali, pozicioni zyrtar i qeverisë italiane ishte se këta njerëz po kërkonin të përmirësonin gjendjen e tyre ekonomike në Itali, prandaj nuk mund të konsideroheshin si refugjatë politikë.

Po le ta gëzojnë medaljen se, siç i thonë një fjale, i duruari i fituari.

Botuar në: xhaxhai.wordpress.com

“ Deportimi i shqiptarëve nga Italia u shoqërua me probleme dhe, në një numër rastesh, u desh ndërhyrja e policisë. Shqiptarët u shqetësuan veçanërisht kur morën vesh se, megjithë premtimet e autoriteteve italiane për t'i dërguar disa prej tyre në zona të ndryshme në Itali, ata u çuan drejt e në Shqipëri. Megjithëse pati shumë simpati për shqiptarët në Itali, pozicioni zyrtar i qeverisë italiane ishte se këta njerëz po kërkonin të përmirësonin gjendjen e tyre ekonomike në Itali, prandaj nuk mund të konsideroheshin si refugjatë politikë.



Banka jote është e gjitha këtu.



Carta Enjoy. Gjithçka që të nevojitet me vetëm 1€ në muaj!

Për të pasur gjithçka, pa pasur llogari.

Enjoy të lehtëson jetën, sepse të jep të gjitha avantazhet e një llogarie rrjedhëse, pa pasur një llogari rrjedhëse. Për të akredituar rrogën, për të blerë në të gjitha dyqanet dhe në internet, për të tërhequr para falas në mbarë Italinë pranë sporteveleve ATM dhe jashtë shtetit në qarkun Mastercard, për të ngarkuar celularin, dhe për shumë shërbime të tjera, zgjidh komoditetin. Zgjidh Kartën Enjoy.

Eja menjëherë në UBI Banca! Për të gjetur filialin më të afërt vizito faqet internet www.ubibanca.com/nuovi-italiani ose telefono në numrin e gjelbër 800 759 759.

PËR MË TEPËR MUND TË DËRGOSH PARA ME



UBI Banca

Mesazh reklamues me qëllime promovimi. Për kushtet e kontratës shiko fletët informuese në të gjitha filialet e Bankave të Grupit UBI Banca.

800.759.759 - www.ubibanca.com

Zgjedhjet e 8 majit në Komisionin e Venecias

KËSHILLI I EUROPËS ENDE NUK I KA VËNË KAPAK NGJARJEVE QË SHOQËRUAN ZGJEDHJET E FUNDIT VENDORE NË SHQIPËRI. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KIE-SË, THORBJORN JAGLAND, I KA DËRGUAR NJË LETËR PRESIDENTIT TË KOMISIONIT TË VENECIAS, GIANNI BUQUICCHIO, LIDHUR ME KËTO ZGJEDHJE, PËR T'I KËRKUAR OPINION PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Sekretari i përgjithshëm i KIE-së, Thorbjorn Jagland, i shkruan presidentit të Komisionit të Venecias, Gianni Buquicchio.

Në letër, që mban datën 24 gusht, Jagland i kërkon Komisionit të Venecias të japë mendimin e tij për "përmirësimet që duhen bërë në kodin zgjedhor në Shqipëri, duke pasur parasysh eksperiencën e fundit".



Ja teksti i plotë i letrës:

"Nuk kam dyshim që jeni në dijeni të situatës në Shqipëri pas zgjedhjeve lokale dhe në veçanti për polemikat lidhur me zgjedhjen e kryebashkiakut të Tiranës. E kam ndjekur situatën nga shumë afër dhe e kam adresuar këtë çështje tek autoritetet shqiptare pasi jam i mendimit që Këshilli i Europës duhet të bëjë gjithçka është e mundur për të ndihmuar Shqipërinë në ndalimin e përsëritjes së ngjarjeve të tilla në të ardhmen.

Për këtë do t'ju lutesha që Komisioni Venecias të mundësojë një opinion i cili do të ndihmojë në përmirësimin e legjislacionit përfshi praktikën elektorale në Shqipëri duke marrë shkas nga eksperiencia e fundit".

Shqipëria do të përdorë një pjesë të borxhit që i ka Italisë për projekte zhvillimi


NËNSHKRUHET SOT NJË MARRËVESHJE QË MUNDËSON PËRDORIMIN NGA ANË E SHQIPËRISË SË NJË PJESE TË BORXHIT (DERI NË 20 MILIONË EURO) QË I KA ITALISË PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE PËR ZHVILLIM NË FUSHAT E ARSIMIT, SHËNDETT DHE TË GJENERIMIT TË PUNËSIMIT

Në ambientet e Ministrisë së Financave të Shqipërisë në Tiranë, ministri Ridvan Bode dhe Ambasadori i Italisë në Tiranë, Saba D'Elia, në emër të qeverive përkatëse, nënshkruan më 24 gusht marrëveshjen që i hap rrugë Programit të konvertimit të një pjese të borxhit që vendi ynë ka ndaj Italisë dhe që është parashikuar në Protokollin e bashkëpunimit dypalësh. Të pranishëm në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ishin edhe ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj, i Shëndetësisë, Petrit Vasili, dhe Kryetari i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim i Ambasadës Italiane, Aldo Sicignano.

Ministri i Financave Bode, duke bërë të ditura detaje të marrëveshjes, tha se një pjesë e borxhit që Shqipëria ka ndaj Italisë deri në shumën 20 milionë euro, për disa kredi të akorduara nga qeveria italiane, nuk do t'i paguhen kësaj të fundit por do të depozitohen në një Fond të veçantë. Fondi do të përdoret për realizimin e projekteve për zhvillim që do të identifikohen bashkërisht nga te dy palët dhe që do të jenë të fokusuar në fushat e arsimit, shëndetit dhe gjenerimit punësimit.

Referuar marrëveshjes, pagesat në këtë fond do të bëhen në njëmbëdhjetë këste. Secili kështu konvertohet në lek, sipas kursit të këmbimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë në datën e depozitimit të kështit. Kësti i parë që do të ketë vlerën 500.000 euro, do të depozitohet në këtë fond brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes. Dhjetë këstet pasuese gjashtëmujore, secili me vlerën prej 1,95 milionë euro, do të depozitohen më 31 tetor dhe 30 prill për pesë vjet rresht.

Për realizimin e këtij programi në mbështetje të politikave të zhvillimit social, do të funksionojë një Komitet i përbashkët Menaxherial, i cili do të pë-



bëhet nga ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij, i asistuar nga përfaqësuesit e Departamentit të Strategjisë dhe Bashkërendimit të Donatorëve pranë Këshillit të Ministrave dhe Ministri të tjera përkatëse; ambasadori italian në Shqipëri ose përfaqësuesi i tij, i asistuar nga anëtarët e Zyrës Italiane të Bashkëpunimit dhe/ose MFA-DGDC.

Afati i përdorimit të fondit për realizimin e projekteve të përzgjedhura është deri në dy vjet që nga çasti i depozitimit të kështit të fundit në llogarinë e fondit. Fondet e krijuara nga depozitimi i kësteve të borxhit për kreditë ekzistuese, dhe të përdorura për projektet përkatëse, do të konsiderohen si shuma borxhi të shlyera kundrejt Qeverisë së Republikës së Italisë. Fondet e papërdorura deri në afatin e vendosur prej dy vjetësh, do t'i kthehen Qeverisë Italiane.

SHKURT KRONIKË

Më 1 tetor, nis regjistrimi i popullsisë

PËR TRI JAVË, RRETH 12 MIJË ANKETUES DO TË SHKOJNË DERË MË DERË TË ÇDO FAMILJEJE TË NUMËROJNË SHQIPTARËT DHE TË HUAJT TË CILËT JANË REZIDENTË TË ZAKONSHËM NË SHQIPËRI NË MOMENTIN E CENSUSIT; NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE; BANESAT (TË BANUARA OSE JO); BANESAT KOLEKTIVE.

Më 1 tetor nis në Shqipëri regjistrimi i shumëpërfolur i popullsisë.

Instituti statistikor (INSTAT) ka nisur përzgjedhjen e 11.712 anketuesve që në periudhën 1-21 tetor 2011 do të realizojnë regjistrimin e popullsisë, të quajtur ndryshe Census. Ata do të vihen në dispozicion të institutit nga 22 shtatori deri më 27 tetor për një kompenso prej 42.000 lekë, rreth 300 euro. Këta do të kontrollohen nga rreth 2.400 kontrolorë dhe nga rreth 150 mbikëqyrës.

Censusi do të mbledhë informacione për individët, banesat dhe njësitë ekonomike familjare duke iu referuar "çastit të Censurit", që do të merret

mesnata e 30 shtatorit – 1 tetorit 2011. Në këtë Census do të përdoret metodologjia tradicionale për mbledhjen e të dhënave, ajo derë më derë.

Duke filluar nga 1 tetori, 11.712 anketuesit (1.420 në Tiranë, 494 në Durrës, 326 në Vlorë, 255 në Elbasan, e kështu me radhë) do të shkojnë derë më derë të çdo familje për mbledhjen e informacioneve.

Tashmë është gati edhe pyetësori. Pjesa mbi të dhënat individuale përmban 40 pyetje, të cilave u duhet dhënë një apo më shumë përgjigje të sakta, me përjashtim të dy pyetjeve të fundit mbi fenë dhe kombësinë, të cilave mund të

zgjidhet të mos i jepet përgjigje.

Për herë të parë pas regjistrimit të vitit 1989, do të mbledhen statistika mbi përkatësinë etnike dhe fetare. Megjithatë, pas ligjit të miratuar në Kuvend dhe amendamenteve të Partisë Drejtësi, Integritet dhe Unitet, të dhënat që do të merren nga pyetësorët nuk do të jenë përfundimtare. INSTAT jo vetëm detyrohet të hetojë çdo deklaratë për kombësinë, por edhe t'i ballafaqojë ato me regjistrin për gjendjen civile dhe të përfshijë në statistikat zyrtare të dhënat e sakta, pra ato që gjenden në regjistrin kombëtar të gjendjes civile.

Sipas ligjit, "të gjithë personat, me

shtetësi shqiptare apo të huaj, si dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e censusit ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar në pyetësorët e censusit të popullsisë dhe të banesave, në mënyrë të plotë, të saktë dhe të besueshme". Përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet "me gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, refuzimi për të bërë deklaram ose deklarimi i rremë dënohet me gjobë".

Ndërkaq nuk shuhet polemikat për deklarimin e përkatësisë fetare dhe etnike. Për Kreshnik Spahiu, nënkryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ligji mbi censusin, jo vetëm që "shkel parimet kushtetuese dhe standardet e BE-së", por edhe miratimi i tij në parlament është bërë në shkelje të pastër të procedurës: kaloi me minimumin e mundshëm të votave (71 pro) falë dy prej deputetëve të mazhorancës që votuan edhe për dy kolegë të tyre që mungonin në sallë.

Neni 19 i Tekstit Unik për Imigracionin (dekretit legjislativ 286 i vitit 1998), i cili disiplinon rastet në të cilat dëbimi i të huajve është i ndaluar, i ndryshuar nga ligji nr. 94 i 2009, është ndryshuar përsëri nga dekretligji Nr 89 i vitit 2011 i konvertuar në ligj në fillim të gushtit (ligji nr. 129 i vitit 2011).

Përpara dekretligjit 89/2011

Përpara Dekretligjit nr. 89, neni 19 i Tekstit Unik, parashikoj hipoteza sipas të cilës një shtetas jokomunitar nuk mund të ishte subjekt i dëbimit.

Paragrafi i parë parashikonte dhe parashikon edhe sot një ndalim absolut të dëbimit. "Në asnjë rast nuk mund të bëhet dëbimi ose kthimi drejt një shteti në të cilin i huaji mund t'i nënshtrohet persekutimit për arsye të racës, gjinisë, gjuhës, kombësisë, fesë, opinionit politik, për kushtet personale apo sociale, e cila do të rrezikonte të dërgohej në një shtet tjetër ku nuk është i mbrojtur nga persekutimi". Është e qartë se bëhet fjalë për një ndalim me karakter humanitar të bazuar

NË Ç'RASTE NDALOHET DËBIMI I TË HUAJVE?

Kam dëgjuar se ligjet e miratuara së fundi kanë ndryshuar normativën mbi ndalimin e dëbimit të shtetasve të huaj. A mund të kem më shumë informacion?

në rrjedhojat që mund të ketë dëbimi për të huajin, gjë që parashikohet jo vetëm nga Kushtetuta italiane, por edhe nga traktatet ndërkombëtare.

Paragrafi i dytë parashikonte dhe parashikon një sërë situatash në të cilat ndalimi nuk është absolut dhe mund të jetë i



përkohshëm.

Ky ndalim është i përkohshëm për të miturit nën 18 vjeç deri në mbushjen e moshës madhore. Në këtë rast nuk cenohet e drejta e fëmijës për të ndjekur prindin ose personin që ka kujdestari e që mund të jetë prekur nga dekreti

i dëbimit.

Është i përkohshëm ndalimi i dëbimit të grave shtatzëna. Gratë, shtatzënia e të cilave vërtetohet nga një certifikatë mjekësore e një specialisti në gjinekologji, nuk mund të dëbohen deri gjashtë muaj pas lindjes së fëmijës. Në rastin e

shtatzënisë, Gjykata Kushtetuese me sentencë nr. 376 të vitit 2000 deklaroi paligjshmërinë kushtetuese për nenin 19, në pjesën ku nuk e shtrin ndalimin e dëbimit edhe për bashkëshortin që bashkëjeton me gruan shtatzënë. Për të shtrirë ndalimin e dëbimit edhe për bashkëshortin, është e nevojshme të plotësohen kushtet e marrëdhënies bashkëshortore dhe të bashkëjetesës. Shtrirja e ndalimit të dëbimit nuk ushtrohet për marrëdhëniet faktike pa kurorë dhe në qoftë se të huajt nuk bashkëjetojnë.

Ndalimi i dëbimit parashikohet për të huajt që kanë leje qëndrimi BE për qëndruesit afatgjatë (ish karta e qëndrimit). Në këtë rast, ama, nëse i huaji konsiderohet si rrezik për rendin publik ose sigurinë e shtetit, pra në rast veprimtarie terroriste, mund të vendoset gjithsesi dëbimi.

Së fundi, neni 19

nga 29 gushti deri më 10 shtator 2011

La Spesa intelligente

0,99
~~1,14~~
Ujë natyral/
I gazuar/Pak i
gazuar
6 x 1,5 L
Euro 0,11 për L
Konfeksioni

2,99
~~3,49~~
Djathë i grirë i
përzier
500 g
Euro 5,98 për kg

4,99
Kartë higjienike
Veluette 24
rrotulla 3 shtresa
Sasi e kufizuar

... dhe disa shembuj të mallrave tanë

1,19
Brumë petë e freskët
265 g
Euro 4,49 për kg

1,29
Biskota Krumiri
300 g
Euro 4,30 për kg

0,45
Çaj i gjelbër
500 ml
Euro 0,90 për L

0,99
Peceta për përdorime të
ndryshme 20 copë

Orient e vlefshme deri në përfundim të mallit. Fotografite janë vetëm për ilustrim. Çmimet dhe karakteristikat mund të ndryshojnë pa paralajmërim edhe për shkak të gabimeve të shtypit. Orientat janë të kufizuara për asnjë konsumim familjar.

www.eurospin.it

parashikonte ndalimin e dëbimit të qytetarëve të huaj që jetojnë me një bashkëshort apo të afërmit italianë deri në shkallën e katërt të lidhjes familjare. Ligji nr. 94 i vitit 2009 e ka të kufizuar: parashikon vetëm në rast bashkëshorti dhe të afërmi të shkallës së dytë. Kështu që ndalohet dëbimi i qytetarëve jokomunitarë që bashkëjetojnë me bashkëshort-

“ Ligji parashikonte dhe parashikon edhe sot një ndalim absolut të dëbimit. "Në asnjë rast nuk mund të bëhet dëbimi ose kthimi drejt një shteti në të cilin i huaji mund t'i nënshtrohet persekutimit për arsye të racës, gjinisë, gjuhës, kombësisë, fesë, opinionit politik, për kushtet personale apo sociale, e cila do të rrezikonte të dërgohej në një shtet tjerë ku nuk është i mbrojtur nga persekutimi".

tët, ose që bashkëjetojnë me një shtetas italian me të cilin kanë një lidhje familjare brenda shkallës së dytë (fëmijët, prindërit, vëllezërit e motrat, gjyshërit dhe nipërit). Dëshmia e lidhjes familjare duhet vërtetuar përmes dokumentacionit zyrtar nga vendlindja. Nëse dokumentacioni mbërrin nga një vend i ndryshëm nga Italia, ai duhet të jetë i përkthyer dhe i legalizuar nga përfaqësitë diplomatike italiane (i legalizuar me vulë Apostille, në rastin e Shqipërisë).

Kushti i bashkëjetesës është themelor dhe shumë Gjykatës kanë konfirmuar rëndësinë e tij thelbësore. Në kah të kundërt mund të përmendet një urdhëresë e Gjykatës së Kasacionit (Urdhëresë nr. 22230 e 29/10/2010), me të cilën gjykatësit vendosin që, në marrëdhënie martesore, mungesa e përkohshme e bashkëjetesës, e diktuar vetëm nga arsyet ekonomike, nuk anulon kriterin e nevojshëm për të ndaluar dëbimin.

Në të gjitha këto hipoteza të përmenduar, ndalimi i dëbimit nuk është i mundur për ata subjekte që konsiderohen si rrezik për rendin publik ose sigurinë e shtetit.

I huaji jokomunitar që ndodhet në një prej situatave të përmendura në nenin 19, ka të drejtë, në bazë të nenit 28 të Dekretit 394 të vitit 1999 të Presidentit, për një leje qëndrimi për arsye humanitare në rast të ndalimit të dëbimit për arsye humanitare, për moshë të mitur për të miturit, për arsye mjekësore në rast të një gruaje të huaj shtatzënë dhe për arsye familjare në rastin e një të huajit që ka një të afërm qytetar italian.

Për të huajin e martuar me një qytetar italian parashikohet gjithashtu, me dekretin legjislativ nr. 30 të vitit 2007 (i cili disiplinon qëndrimin dhe lëvizjen e qytetarëve të BE-së dhe të afërmeve të tyre), që të mund të aplikojnë për kartë qëndrimi si të afërm të shtetasve të BE. Kjo

mundësi u jepet edhe bijve deri në 21 vjeç (ose mbi 21 vjeç që janë në ngarkim) dhe prindërve në ngarkim.

Pas reformës

Dekretligji 89 i vitit 2011, ka sjellë ndryshime në nenin 19 të Tekstit Unik. Është futur në fakt një dispozitë që synon të mbrojë, në rast dëbimi, kategori të veçanta delikate. Në fakt, është vendosur që "refuzimi i hyrjes apo i ekzekutimit të dëbimit të njerëzve me aftësi të kufizuara, të të moshuarve, të miturve, anëtarëve të familjeve me një prind të vetëm dhe i fëmijëve të mitur apo atyre që janë viktime të dhunës të rëndë psikologjike, fizike ose seksuale, të kryhet në mënyrë të pajtueshme me rrethanat individuale personale, pas verifikimit".

Është me siguri diçka e veçantë që parlamenti ka futur këtë paragraf në një nen i cili mbron qytetarët jokomunitarë për të cilët është i ndaluar dëbimi dhe se asgjë nuk është thënë në lidhje me mundësinë e riatdhesimit të asistuar.

Është gjithashtu e qartë se qëllimi i ligjberësit është që t'i kushtojë vëmendje të veçantë mënyrave se si duhet bërë riatdhesimi i detyruar i personave që ndodhen në kushte veçanërisht delikate.

Avv. Andrea De Rossi

Si të lidhem me konsullatën tonë në Milano?

Po kërkoj të kontaktoj me konsullatën e Milanos prej 2 muajsh por pa rezultat. Mund të më thoni nëse është hapur dhe nëse respekton oraret? Si futesh në konsullatë, në bazë të një numri apo thjesht me radhë?

Konsullata e Përgjithshme e Shqipërisë në Milano ka një web-site të vetin me adresë: <http://www.consolatoalbanesemilano.org/> në të cilin ofron informacione të ndryshme mbi praktikën konsullore që ofron, dhe veçanërisht për pasaportat biometrike, përfshirë edhe një lajmërim që përditëson rregullisht me pasaportat e reja të gatshme për t'u tërhequr.

Për disa prej shërbimeve konsullore duhet shkuar personalisht në Konsullatë (pikërisht për ato për të cilat kërkohet prania e personit, si për shembull, aplikimi për pasaportën biometrike), të tjera me anë të

shërbimit postar (si marrja e një vërtetimi konsullor, e një certifikate identiteti etj.). Meqë nuk e specifikoni për ç'arsye dëshironi të viheni në kontakt me Konsullatën bëni mirë të lexoni seksionin "informacione" dhe të shihni si duhet të veprojnë në rastin tuaj. Nëse ju duhet të shkoni personalisht në Konsullatë, duhet të mbani radhën, zakonisht të gjatë. Konsullata e Milanos nuk ka përcaktuar ndonjë mënyrë për marrje takimi, siç ka bërë, për

Përfaqësitë konsullore shqiptare qëndrojnë mbyllur vetëm në ditët që konsiderohen festive në Shqipëri dhe Itali.

Kontaktimi me telefon i konsullatave tona apo i zyrës konsullore në Romë mbetet problem për imigrantët për të cilin shpesh është shkruar. Konsullata e Milanos në numrat e saj të telefonit përgjigjet me një sekretari telefonike që jep informacione të ndryshme standarde. Ndërsa numrave të

Consolato Generale della Repubblica d'Albania a Milano
Piazza Duomo 17 - 20121 Milano
Tel. 02/8051265 - 02/86467782 - 02/86467423
Fax. 02/86910853

Per emergenze cell. 392.0686139
Mail: info@consolatoalbanesemilano.org
orario: Lunedì-Venerdì dalle 9-14 (escluse festività nazionali)

shembull, Ambasada jonë në Romë për aplikimet për pasaportat biometrike.

Në seksionin e kontakteve do të gjeni adresën e saktë, numrat e telefonit, një numër celulari për rastet urgjente dhe orarin e pritjes, siç e keni këtu.

celularit të vënë në dispozicion qoftë nga konsullata e Milanos qoftë nga zyra konsullore pranë Ambasadës në Romë, u përgjigjen thuajse gjithnjë.

Keti Biçoku

Problemet shëndetësore dhe përtëritja e lejes për studime

Im bir ndjek Universitetin në Itali dhe ka një lejeqëndrim për studim. Për shkak të problemeve të rënda shëndetësore, nuk ka pasur mundësi të japë provimet. Ekziston mundësia që t'i përtërihet leja e qëndrimit?

Zgjedhjet e ligjvënësit

Leja e qëndrimit për studim i lëshohet shtetasit jo komunitar, që dëshiron të vijë në Itali për të ndjekur një kurs studimi.

Legjislatori, në rregullimin e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve jo komunitarë në Itali, ka bërë një zgjedhje: ka kufizuar numrin maksimal të të huajve në vendin pritës, me qëllim që t'i sigurohen atyre kushte të përshtatshme jetese dhe pune, me pasojën e pashmangshme të kthimit në vendin e origjinës të atyre që nuk janë në rregull, si për sa i përket hyrjes ose lejeqëndrimit, ose në rast se mungojnë kushtet që kishin bërë të mundur dhënien e lejeqëndrimit, pra të atyre që leja e qëndrimit u ka skaduar dhe nuk mund të rinovohet më tej.

Diskrecioni administrativ

Mungesa e kushteve ose e parakushteve që justifikojnë qëndrimin e rregullt të huajit

në territorin italian, në shumicën e rasteve bën që të hidhet poshtë ose të hiqet automatikisht leja e qëndrimit. Por në raste të caktuara legjislatori i ka lënë një farë lirie administratës në vlerësimin dhe peshimin e fakteve apo elementeve të rinj që gjithsesi mund të lejojnë, madje edhe duke mos ekzistuar më disa kushte të caktuara, qëndrimin e të huajve në territorin italian.

Angazhimi dhe serioziteti i studentit të huaj

Në këto raste hyn edhe leja e qëndrimit për studim, në kuadrin e së cilës duhet të merret parasysh angazhimi dhe serioziteti i studentit në ecimin e kursit të studimit të zgjedhur. Qëllimi i kësaj leje, në fakt, është që i huaji të ketë mundësi për të përmirësuar nivelin e tij kulturor nëpërmjet pjesëmarrjes në kurse studimi, për të zgjeruar njohuritë e tij dhe për të përfunduar studimet me sukses në afatin kohor të përcaktuar.

Prandaj kur parashikon kushte të caktuara për rinovimin e lejeve të qëndrimit, legjislatori është përpjekur të balancojë interesin e të huajit për të ndjekur formimin e tij në Itali, me atë të shtetit, për të shmangur rinovime të përsëritura të lejes, që nuk përputhen më synimin e lejeqëndrimit për arsye studimi.

Për të shmangur rinovime të përsëritura, legjislatori ka lejuar gjithashtu edhe konvertimin e lejes së qëndrimit për qëllime studimi, duke plotësuar kushtet për një leje qëndrimi të ndryshme.

Çfarë parashikon norma

Në rastin e kurseve universitare, legjislatori parashikon marrjen me sukses të një numri minimal provimesh për çdo vit akademik. Në veçanti, Neni 46 i Rregullores së zbatimit të Dekretit të Presidentit 394 të vitit 1999 parashikon që leja e qëndrimit për arsye studimi i përtërihet studentit që në vitin e parë ka kaluar me sukses një provim dhe në vitet e mëpasshme të paktën dy provime. Për arsye të rënda shëndetësore ose të forcës madhore, të dokumentuara rregullisht, leja e qëndrimit mund të rinovohet edhe për studentët që kanë marrë vetëm një provim.

Gjithsesi lejeqëndrimet për studime nuk mund të lëshohet për më shumë se tre vjet pas kohëzgjatjes së kursit të studimeve.

Normativa dikton pra rregulla specifike mbi numrin e provimeve që duhen kaluar dhe mbi numrin e viteve përtej të cilëve leja nuk mund të rinovohet.

Është ama e vërtetë që në rast pengesash që nuk varen nga studentit, Administrata mund të bëjë vlerësime në bazë diskrecionale, dhe të gjykojë rrethanat për të rinovuar gjithsesi lejen e qëndrimit, në bazë të faktorëve favorizues, siç parashikohet nga Neni 5, paragrafi 5 i Tekstit Unik për Imigracionin.

Sentenca n. 5762 e 2011 e TAR Lazio

Në këtë kuadër, kohët e fundit është shprehur edhe Drejtësis Administrative (Sentenca n. 5762 të vitit 2011 e TAR Lazio). Gjyqtarët kanë theksuar se parashikimi i një numri minimal provimesh të marra është një kriter për parandalimin e përdorimit për arsye të rreme të një lejeqëndrimi, qëllimi i të cilës është pikërisht përfundimi i një kursi studimesh.

Por mund të ndodhë, që për shkak të forcës madhore, objektivist studentit mund të pengohet në përmbushjen e kërkesës për numrin minimal të provimeve të dhëna (në rastin konkret të shqyrtuar nga gjykatësit bëhej fjalë për aksident rrugor).

Në një rast të tillë, në qoftë se pas kapërcimit të pengesës, studentit rifillon me sukses studimet, ky element duhet konsideruar si favorizues në rinovimin e lejes nga ana e Administratës, pikërisht sepse përveç se parashikohet në vija të përgjithshme nga dispozitat e Nenit 5 të Tekstit Unik për Imigracionin, plotëson qëllimin për të cilin është lëshuar lejeqëndrimi.

Avv. Andrea De Rossi



A Torino con
un guasto
all'auto

**TRASFERIMENTO VELOCE
DI DENARO IN ITALIA A PARTIRE
DA**
€ 4.90

Riprendi il viaggio
verso Firenze

Sorprendi i tuoi cari su
www.4-90forbetter.it



Regala momenti di gioia ai tuoi amici ed alla tua famiglia su
4-90forbetter.it ed otterrai un grande impatto con un piccolo gesto
Offerta valida dal 22.11.2010 per i Paesi zona EURO.

• Trasferimento di denaro •



moving money for better

Il denaro a' gestione non e' disponibile in minuti, compatibilmente ai termini e condizioni del servizio, inclusi gli orari di apertura dei punti vendita degli Agenti e le differenze di fuso orario. Frase di visione del modulo To Send per le condizioni del servizio.